GJERGJI VANGJELI

MIRANDA SPAHIU

# LIBËR PËR MËSUESIN
# EDUKIM PËR SHOQËRINË 1

BOTIME

pegi

# Përmbajtje


| | |
|---|---|
| Hyrje | 4 |
| Çfarë përmban ky libër? | 4 |
| Ç'të reja sjell teksti "Edukim për shoqërinë 1"? | 4 |
| **KOMPETENCAT E FUSHËS "SHOQËRIA DHE MJEDISI"** | |
| Qëllimi i fushës "Shoqëria dhe mjedisi" | 6 |
| -Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë | 7 |
| -Kompetencat e lëndës "Edukim për shoqërinë 1" dhe tematikat e saj | 9 |
| -Rezultatet e të nxënit KSNA 1/ shkalla e parë/ klasa përgatitore, klasa I, II | 10 |
| -Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare | 12 |
| -Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit | 13 |
| -Metodologjia e mësimdhënies | 13 |
| -Nxënësit/et me nevoja të veçanta | 14 |
| ***Materialet dhe burimet mësimore*** | 14 |
| -Situata e të nxënit | 14 |
| -Vlerësimi i nxënësit/es | 14 |
| ***PLANIFIKIMI I KURRIKULËS*** | |
| Planifikimi vjetor i lëndës, sipas tre mujorëve | 16 |
| Planifikimi tre mujor | |
| ***MODELE MËSIMI*** | 59 |

# Hyrje

*I nderuar mësues/e dhe prind,*

Teksti "Edukim për shoqërinë 1" është ndërtuar mbi bazën e fushës "Shoqëria dhe mjedisi", e cila është njëra nga shtatë fushat kurrikulare që u krijon nxënësve mundësitë të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Kjo fushë e ndihmon nxënësin/en për të zhvilluar të kuptuarit e tij/saj për botën, njerëzit, vlerat, proceset mjedisore në kohë, në hapësirë, në vende dhe në rrethana të ndryshme. Njohuritë e këtij fushe gjithashtu mundësojnë që nxënësi/ja të kultivojë identitet personal, shoqëror, kulturor, shtetëror e kombëtar, të mësuarit për të jetuar bashkë me të tjerët, si dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Njohuritë nga fusha "Shoqëria dhe mjedisi" në shkallën e parë dhe të dytë kurrikulare (klasa parafillore dhe klasat 1-5 fillore), janë të rëndësishme për t'u mësuar për arsye se përmes saj nxënësit/et aftësohen për njohjen më të mirë të vetes, komunitetit, shoqërisë dhe mjedisit jetësor. Këto njohuri ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive elementare për ndërmarrjen e aktiviteteve në jetën e përditshme shoqërore, në mënyrë që të vetëdijësohen për rëndësinë e marrjes së vendimeve të përgjegjshme.

## *Çfarë përmban ky libër?*

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e Qytetarisë 1-6 të shkallës së parë (klasa K-2) të lëndës "Edukim për shoqërinë 1", miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014.

Ai synon të orientojë dhe ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e parë, për të përmbushur qëllimet e fushës së kurrikulës "Shoqëria dhe mjedisi" për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe ato kyçe te nxënësit/et e klasës së parë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, bazuar në dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia dhe të nxënit.

Libri u ofron mësuesve njohuritë për dokumentacionin e ri, si: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, programin mësimor* dhe vlerësimin, bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave.* Tri fazat më të rëndësishme janë përkatësisht:

a) planifikimi i të nxënit;

b) metodologjia e mësimdhënies;

c) vlerësimi i të nxënit, bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Libri zbërthen programin në një variant analitik dhe në mësime model, me metoda, teknika e strategji që lehtësojnë të nxënit e nxënësve për veprimtari të larmishme dhe efektive, me procedime metodike të çdo ore mësimore, me forma të ndryshme të konceptimit dhe të zhvillimit të orëve të veprimtarisë dhe me formate të tilla si: veprimtari "Mësoj duke luajtur", "Unë jam fotoreporter", si dhe me burime informacioni e mjete didaktike e mësimore që janë të domosdoshme dhe të nevojshme.

## *Ç'të reja sjell teksti "Edukim për shoqërinë 1"?*

*Së pari,* ky tekst është ndërtuar në mënyrë të tillë që mund të kuptohet dhe të përdoret nga mësuesi/ja dhe nga prindi, duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat për zbatimin e kurrikulës së re të lëndës "Edukim për shoqërinë 1". "*Të gjithë njerëzit kanë motivet dhe arsyet për ndërmarrjen e veprimeve, por shkaqet shkojnë përtej këtyre*" (anonim). Në thelb, ky tekst është organizuar sipas lidhjes logjike veprim-pasojë, ku pasojat mund të jenë pozitive dhe negative.

*Së dyti*, teksti realizon tri mjedise të të nxënit, të cilat janë:

1. Mjedisi *"Komunikimi dhe të shprehurit"*, ku nxënësit/et njihen me një "rast studimi", i cili krijon pikat hyrëse për lidhjen e njohurive/shkathtësitë e qëndrimet e reja në analogji me jetën e tyre reale, duke nxjerrë në pah vlerat e qëndrimet e gjithësecilit.
2. Mjedisi "*Shiko dhe lexo*", ku realizohet një "*kërkimi bazuar në dialogun formues*", "*kërkim*" në këtë mjedis do të thotë të kërkosh/gjesh apo të rikërkosh për diçka, për të gjetur gjëra të reja. Këtë informacion nxënësit/et mund ta përdorim për t'i përmirësuar gjërat. E veçanta në këtë "*dialog*" është që personat që dialogojnë vendosen në kushte të barabarta: opinionet e tyre kanë të njëjtën vlerë dhe peshë me nxënësit/et e tjerë që nuk u jepet mundësi për të folur. Nxënësit/et mund të mos bien dakord, por ata duhet të pranojnë ekzistencën e opinioneve të ndryshme dhe të tregojnë respekt për njëri/a-tjetrin/ën, duke u bërë kështu dëgjues të mirë. Ky mjedis i jep përgjigje edhe pyetjes kërkimore, e cila gjithmonë është ndërtuar me pyetjet "Pse?","Si?", "Kur?" "Çfarë ?" etj., ku nxënësit/et shpesh nisin të rimendojnë e të reflektojnë. Po çfarë kuptojmë me "formues" në këtë mjedis, do të thotë t'i japësh një formë apo t'u bësh një modelim të ri gjërave. Kjo do të thotë që nxënësit/et vlerësojnë duke dhënë këshilla/sugjerime, teksa lindin edhe ide të reja. Në këtë mënyrë, mund të zgjidhen edhe problemet apo mund të bëhen përmirësimet e tyre. "*Ky mjedis është një mundësi si për mësuesin ashtu edhe për nxënësin*".
3. Mjedisi *"Mësoj duke kërkuar"*. Për zhvillimin e temave të mësimit janë përzgjedhur metoda, teknika e strategji të përshtatshme dhe të realizueshme me dhe nga vetë nxënësit/et; është shfrytëzuar përdorimi i skemave, i tabelave dhe i formave të tjera të shfaqjes së tyre, të cilat e bëjnë më të kuptueshme ndërtimin e njohurive dhe kuptimin e detyrave, të kërkesave dhe të ushtrimeve të ndryshme; janë zgjedhur forma të larmishme për punë individuale, në çift, në grupe të vogla dhe të mëdha.

*Si përfundim,* ne shpresojmë që ky libër të zbatohet me dashuri nga ju mësues/e dhe prindër, siç autorët e kanë hartuar atë.

## KOMPETENCAT E FUSHËS “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Kjo pjesë ka si qëllim kuptimin për krijimin e kushteve për ndërtimin e ***kompetencave të fushës*** “Shoqëria dhe mjedisi”, si dhe të ***kompetencave kyçe***, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën nëpërmjet realizimit të ***temave ndërkurrikulare*** në lëndën “Edukim për shoqërinë 1”. Ato janë gjithashtu një komponent i rëndësishëm i programit të Qytetarisë, për të përmbushur rolin e nxënësve si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

**“Shoqëria dhe mjedisi”** zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë *arsimin fillor* (AF), klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët (AMU)* klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre 9-të vite shkollimi.

*Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit*. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. kompetenca e të menduarit;
3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. kompetenca personale;
6. kompetenca qytetare;
7. kompetenca digjitale.

Njohuritë nga fusha “Shoqëria dhe Mjedisi” u mundësojnë nxënësve përvetësimin dhe kultivimin gradual të kompetencave kryesore. Këto pasqyrohen përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t`i reflektojnë. Organizimi i mësimit duhet t`i aftësojë nxënësit/et për: komunikim nëpërmjet simboleve, shenjave, shprehjes së tolerancës, lidhjes së vendimeve me pasojat, të mësuarit për të mësuar, punë në grupe, mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit, veprime të pavarura dhe të përgjegjshme, bashkëndjenjë, raporte ndërnjerëzore, respektimin e dallimeve dhe pjesëmarrje aktive. Të gjitha këto janë të përfshira në rezultatet e të nxënit të kësaj fushe për këtë nivel.

### *Qëllimi i fushës “Shoqëria dhe mjedisi”*

Kjo fushë synon që nxënësit/et:

- të aftësohen për t’u bërë qytetarë aktive dhe të përgjegjshëm në dimension lokal, kombëtar, rajonal, evropian e global, duke ndërtuar identitetin, individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- të zhvillojnë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë;
- të zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to, përmes studimit të të gjithë përvojës njerëzore;
- të aftësohen për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët, në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit;
- të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, duke mos besuar përgjigjen e paargumentuar dhe duke respektuar përpikmërinë e burimeve historike;
- të zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë ndërmjet aspekteve fizike dhe humaneve të rajoneve e vendeve në botë;

- të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- të zotërojnë shkathtësinë e kërkimit, interpretimit, organizimit të njohurive dhe të komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme.

***Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë***

***Tabela 1***

| |
|---|
| **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit** (*Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)* |
| 1.1 Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.<br>1.2 Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.<br>1.3 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.<br>1.4 Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim. |
| **2. Kompetenca e të menduarit** (*Nxënësi/ja mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)* |
| 2.1 Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar, gjatë një debati ose publikimi në medie.<br>2.2 Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.<br>2.3 Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).<br>2.4 Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.<br>2.5 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.<br>2.6 Përdor krahasimin dhe "studim rasti" për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore. |
| **3. Kompetenca e të nxënit** *(Nxënësi /ja mëson për të nxënë)* |
| 3.1 Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.<br>3.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.<br>3.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.<br>3.4 Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.<br>3.5 Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.<br>3.6 Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe të mjeteve, gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren). |

| | |
|---|---|
| **4.** | **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive)*** |
| 4.1 | Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. |
| 4.2 | Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre. |
| 4.3 | Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). |
| **5.** | **Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)*** |
| 5.1 | Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup. |
| **6.** | **Kompetenca qytetare *(Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)*** |
| 6.1 | Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit. |
| 6.2 | Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë. |
| **7.** | **Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*** |
| 7.1 | Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. |
| 7.2 | Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik). |

## Kompetencat e lëndës "Edukim për shoqërinë 1" dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën "Shoqëria dhe mjedisi", në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht *zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.* Këto kompetenca i përgatitin individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike. Në përmbushjen e këtyre kompetencave nxënësi/ja:

- Njeh dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

- Argumenton rëndësinë që ka *kompetenca shoqërore dhe qytetare* për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.

- Argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut.

- Argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.

- Përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij/saj në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.

- Zhvillon këndvështrimin e tij/saj hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.

- Eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.

- Pranon rëndësinë që ka *kompetenca shoqërore dhe qytetare* për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë, si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.

-Kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror.

- Njeh lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe vepron për të realizuar atë.

- Njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën.

- Kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.

- Komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.

- Është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai/ajo pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.

- Vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.

-zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.

**Tematikat** mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënit të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit/es apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Këto tematika janë:

- individët, grupet, shoqëria;
- kultura;
- prodhimi, shpërndarja dhe konsumi;
- pushteti, autoriteti, qeverisja.

Koha mësimore për tematikë për secilën klasë[1] sipas programit të lëndës së qytetarisë (Edukim për shoqërinë klasa K-2) zhvillohet në 35-orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

***Tabela 2***

| Tematika, shkalla | Individët, grupet, shoqëria | Kultura | Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia | Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve | Pushteti, autoriteti, qeverisja | Proceset shoqërore | Prodhimi, konsumi, shpërndarja | Totali i orëve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shkalla 1** | | | | | | | | |
| Klasa përgatitore | 20 | 10 | 10 | 5 | 10 | 5 | 10 | ***70*** |
| Klasa e parë | 20 | | | | 8 | | 7 | **35** |
| Klasa e dytë | 20 | | | | 8 | | 7 | **35** |

**Rezultatet e të nxënit KSNA 1/ Shkalla e parë/ klasa përgatitore, klasa I, II**

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë 7 **kompetencat kyçe** dhe se si t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohen dhe arrihen përgjatë një shkalle të caktuar. **Kompetencat kyçe** të shkallës së parë lidhen me klasën **përgatitore, klasa I, II**, të AF-së, ku mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç kompetencave lëndore të "Edukim për shoqërinë", të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit/et e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

[1] **Tabela.** Orët përkatëse mësimore të tematikave

**Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së dytë:**

1. **Proceset shoqërore.**

   **Nxënësi/ja:**

- përshkruan ngjarje shoqërore, kulturore e historike si dhe dukuri natyrore duke marrë shembuj nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara;
- përshkruan ngjarjet më të rëndësishme të historisë personale dhe asaj familjare, historisë së shkollës, historisë së zonës e rajonit, duke identifikuar ndryshimet në historinë e familjeve të tyre ose të komunitetit ku jeton.

2. **Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia.**

   **Nxënësi/ja:**

- përshkruan historinë personale dhe familjare, historinë e shkollës, historinë e zonës dhe rajonit, duke përdorur saktë datat dhe kuptuar vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë;
- identifikon dhe respekton dallimet kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare nëpërmjet njohjes së kulturave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të kaluarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën.

3. **Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve.**

   **Nxënësi/ja:**

- identifikon veçoritë e mjedisit gjeografik dhe banorëve që jetojnë në një hapësirë të caktuar;
- dallon mënyra të përdorimit të burimeve të caktuara në bashkësinë ku jeton.

4. **Pushteti, autoriteti, qeverisja.**

   **Nxënësi/ja:**

- dallon të drejta dhe përgjegjësi individuale në grupin social ku jeton, si: familja, bashkëmoshatarët, klasa, shkolla;
- identifikon disa nga qëllimet e qeverisjes vendore dhe asaj shtetërore;
- jep shembuj se si sigurohen nevojat dhe dëshirat e njerëzve në niveleve të ndryshme si familja e komuniteti;
- shjegon se individët dhe grupet ku ata bëjnë pjesë duhet të pranojnë diversitetin, për të ruajtur marrëdhënie miqësore me qëllim që sigurohet paqja dhe jetesa paqësore;
- dallon shkallë të ndryshme qeverisjeje nga klasa, shkolla e bashkësia dhe identifikon disa persona përgjegjës në çdo nivel;
- dallon faktorët që kontribuojnë për bashkëpunimin ndërmjet nxënësve dhe grupimeve që dallohen në shkollë dhe në lagje dhe disa nga shkaqet e konflikteve ndërmjet tyre;
- përshkruan ndryshimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave individuale dhe të grupeve.

5. **Prodhimi, konsumi dhe shpërndarja.**

   **Nxënësi/ja:**

- zbulon që njerëzit kanë parapëlqime të ndryshme dhe bëjnë zgjedhje të ndryshme. Ai/ajo dallon dhe vlerëson ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet individëve;
- identifikon personazhe, që planifikojnë të fitojnë para, thotë me fjalët e tij ç'është paraja dhe dallon monedhën si një nga format e parasë. Ai/ajo njeh rëndësinë e të kursyerit të parave për të blerë diçka, për të plotësuar një dëshirë;
- zbulon si njerëzit në një familje janë të ngjashëm dhe të ndryshëm, si ata punojnë së bashku për një jetë më të mirë. Ai bëhet i vetëdijshëm që të gjitha familjet, për të jetuar, duhet të kenë ushqim, veshje dhe shtëpi banimi;

- fillon të kuptojë ndryshimin ndërmjet një nevoje dhe një dëshire. Ai/ajo kupton se si punët (profesionet) u sigurojnë anëtarëve të familjes plotësimin e nevojave dhe të dëshirave dhe diskuton për rëndësinë që ka puna, për të paguar për nevojat dhe dëshirat tona.

**6. Individët, grupet, shoqëria**

**Nxënësi/ja:**

- identifikon rolet si shembull i sjelljeve të të nxënit të tij/saj në situatat e grupit, si: nxënës/e, anëtar familje, anëtar i barabartë i grupit në një lojë, ose anëtar i klubeve të ndryshme shkollore;
- jep shembuj të grupeve dhe tregon ndikimin e ligjeve dhe rregullave. Nga ana tjetër ai/ajo tregon ndikimet e moshatarëve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet kulturore, p.sh. rregullat e klasës, të shkollës, të komunitetit;
- identifikon shembuj të konflikteve ndërmjet grupeve, individëve ose institucioneve, si dhe ndërmjet besimit individual dhe ligjeve, rregullave dhe praktikave qeverisëse në shkollë, familje dhe komunitet;
- tregon grupe dhe institucione që punojnë për plotësimin e nevojave individuale, si dhe për sigurimin e të mirave të përbashkëta, duke identifikuar edhe shembuj për "studim rasti", kur këto grupe dhe institucione nuk punojnë në këtë drejtim.

**7. Kultura.**

**Nxënësi/ja:**

- dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet në grupe të caktuara si familje, klasë, shkollë, shoqërinë në tërësi, duke iu referuar kulturave, nevojave të përbashkëta njerëzore dhe interesave të tyre në mjedisin ku jeton;
- dallon se si përvojat e individëve të caktuar mund të interpetohen ndryshe nga njerëzit;
- dallon si gjuha shqipe, tregimet, folklori, muzika, krijimet i japin mundësi individit të shprehë vetveten dhe si ajo ndikon në sjelljen e të tyre;
- dallon ndryshimet që ekzistojnë, në mënyrën si mendojnë njerëzit, ndajnë dhe dallojnë në mes tyre në çështje të ndryshme të jetës së përditshme etj.
- jep shembuj për rëndësinë që ka uniteti kulturor dhe të diversiteti brenda dhe në mes grupeve të ndryshme si: shkollë, komunitet, popullsi autoktone etj.

### *Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare*

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin/en, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- ✓ identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave;
- ✓ zhvillimi i qëndrueshëm;
- ✓ mjedisi;
- ✓ ndërvarësia;
- ✓ bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësisë qytetare, nxënësi/ja mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai/ajo ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin/en të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore.

Nxënësi/ja ndërgjegjësohet për të drejtat e tij/saj, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

### *Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit*

Lënda e qytetarisë ("Edukim për shoqërinë 1" klasa K-2) duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

*Çfarë do të thotë kjo?*

*Së pari*, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.

*Së dyti*, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

### *Metodologjia e mësimdhënies*

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit/et të zhvillojnë orë mësimore bazuar në:

- Ndërveprimin aktiv ndërmjet mësuesit/es dhe nxënësve.
- Shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve.
- Pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore.
- Pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake.
- Përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik ndërmjet mësimdhënies dhe të mësuarit, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimi nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënit, kur roli i mësuesit/es është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai/ajo motivon një ndërveprim të efektshëm ndërmjet nxënësve dhe mësuesit/es, ndërmjet punës në grupe të vogla dhe të mëdha, ndërmjet punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë nxitja e ideve të ndryshme nga nxënësit/et, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Si elemente të një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit/et në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Kërkesat e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen "disiplinën" mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione e këndvështrime nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të tyre, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollor. Në këtë kontekst lënda e qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm edhe shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si "studim rasti" për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim "studim rasti" nga komuniteti shërbejnë *si ura lidhëse* ndërmjet formimit të nxënësve në shkollë dhe jetës reale, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruari reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi/ja do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit/et përdorin dhe zhvillojnë mësimdhënie ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues/e-nxënës/e, mjedis fizik, materiale didaktike, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit/et.

### *Nxënësit me nevoja të veçanta*

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit/et duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit/et janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që të përputhet me stilet e të nxënit të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

*a) Nxënësit/et me vështirësi në të nxënë*

Shumë nxënës/e me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit/et e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënit, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit/et me nevoja të veçanta.

Në studim rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës/e me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit/et. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

*b) Nxënësit/et e talentuar*

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit/et duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit/et të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

### *Materialet dhe burimet mësimore*

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën "Shoqëria dhe mjedisi" ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin/en. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi/ja është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësit/et të kenë akses në burimet e ndryshme të të nxënit.

### *Situata e të nxënit*

*Situatat e të nxënit* për secilin model të planifikimit ditor, është sugjeruese, sepse kërkon të nxisë dhe të orientojë mësuesit/et rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin e orës mësimore, dhe për këtë arsye vendosja e rezultateve të të nxënit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund të zhvillojë këtë situatë apo të zhvillojë temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij. Në librin tonë me situatë të të nxënit kuptohet veprimtaria që realizohet në mjediset: "Komunikimi dhe të shprehurit", "Shiko dhe lexo" dhe "Mësoj duke kërkuar".

### *Vlerësimi i nxënësit*

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të

nxënit, në nivel klase dhe shkalle të nxënësve. Me këtë informacion, mësuesi/ja merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësit/et të kompetencave të fushës "Shoqëria dhe mjedisi". Mësuesit/et duhet të përdorin situata të jetës reale, që përfshijnë shoqërinë dhe mjedisin si pikënisje për vlerësimin e nxënësve.

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për ta. Mësuesi/ja mund të vlerësojë nxënësit/et përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Puna e mbledhur ofron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ajo gjithashtu i ofron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

Në klasat I-III, nxënësi/ja vlerësohet:

- ✓ me vlerësim përshkrues për rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës. Ky vlerësim realizohet 1 herë në tre muaj.
- ✓ me vlerësim përmbledhës për rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës në fund të vitit shkollor.
- ✓ me vlerësim vjetor duke marrë vlerësim për lëndën dhe për kompetencat kyçe.

Vlerësimi i nxënësit/es bëhet për arritjet e tij/saj akademike, për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe për kontributin e tij/saj si pjesëtar komuniteti.

Vlerësimi kryhet:

- nga mësuesi/ja, referuar evidencave që mban;
- nga nxënësit e tjerë të klasës, nëpërmjet fishave, simboleve dhe fletëve të vlerësimit;
- nga vetë nxënësi/ja nëpërmjet fletëve të vetëvlerësimit dhe shënimeve individuale që mban nxënësi/ja për punën e kryer.

Vlerësimi përshkrues dhe përmbledhës bëhet me 5 shkallë:

- ➢ **Shkalla 1**. "*Arritje të pakënaqshme*"
- ➢ **Shkalla 2**. "*Arritje që kanë nevojë për përmirësim*"
- ➢ **Shkalla 3**. "*Arritje të kënaqshme*"
- ➢ **Shkalla 4**. "*Arritje shumë të kënaqshme*"
- ➢ **Shkalla 5**. "*Arritje të shkëlqyera*"

Vlerësimi i nxënësit/es mbështetet në portofolin e të nxënit. Ai përmban shumëllojshmëri punimesh dhe detyrash të zgjedhura nga vetë nxënësi/ja.

Rubrikat e portofolit janë 4:

- ⦿ Detyrat dhe punimet në shtëpi (15%)
- ⦿ Detyrat dhe punimet në klasë (30%)
- ⦿ Projektet dhe punimet tematike (25%)
- ⦿ Testet dhe detyrat e kontrollit (30%)

# PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor. Planifikimi i këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: liri, fleksibilitet dhe përgjegjëshmëri. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij përgjatë vitit, janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës* dhe *dokumentet* përkatëse. Këto dokumente janë:

1) Plani vjetor i lëndës së "Edukim për shoqërinë", sipas tremujorëve;
2) Planifikimi tremujor i lëndës.

Planifikimi i planit vjetor dhe tremujor, bëhet sipas ndarjes së kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i klasës së parë "Edukim për shoqërinë", të dhënë në tabelën e mëposhtme[2]:

*Tabela 3*

| | **Individët, grupet, shoqëria** | **Pushteti, autoriteti, qeverisja** | **Prodhimi, konsumi, shpërndarja** | **Gjithsej orë** |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e parë** | | | | |
| **Klasa e parë** | 20 | 8 | 7 | 35 orë |

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me tremujore, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim viti të ri shkollor. Pra kemi tashmë një term të ri *planifikim tre mujor* dhe *jo semestër.*

Temat mësimore jane renditur sipas programit, por, mësuesi/ja është i/e lirë të ndryshojë këtë planifikim në varësi të situatave të nxënies sipas kushteve të klasës, lidhjes ndërlëndore, temave ndërkurrikulare dhe procesit të vlerësimit të nxënësit.

Më poshtë vijojnë tabelat e:

a) planifikimit vjetor të lëndës sipas tremujorëve;

b) planifikimit tremujor të lëndës.

Tremujorët në modelin e mëposhtëm i kemi ndarë, duke bërë një përllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave me + ose –, që çdo mësues/e i llogarit vetë.

[2] Orë të sugjeruara për çdo tematikë

## *Planifikimi vjetor i lëndës, sipas tremujorëve*

<table>
<tr><th rowspan="2">Tematikat</th><th colspan="3">Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave</th></tr>
<tr><th>Shtator – Dhjetor<br>13 orë</th><th>Janar – Mars<br>12 orë</th><th>Prill - Qershor<br>3 orë + 7 orë Modul</th></tr>
<tr><td>Tematika 1:<br>Individët, grupet, shoqëria<br><br>Unë dhe të tjerët<br><br>Orë të sugjeruara:<br>10 orë</td><td>Kush jam unë?<br>- Shpreh tiparet e tij/saj kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët.<br>- Dallon tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai/ajo jeton.<br>Ku banoj unë?<br>- Vendos veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe e sheh veten si pjesë e tij/saj.<br>Unë kam të drejta.<br>- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.<br>- Vlerëson mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve.<br>Unë marr përgjegjësi.<br>- Respekton vetveten dhe shpreh me besim qëndrimin e tij/saj.<br>- Shpreh përgjegjësinë e tij/saj ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.<br>Unë kam një ëndërr...<br>- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj.<br>- Shpreh nevojat dhe dëshirat e tij/saj.<br>Familja ka nevojë për mua.<br>- Dallon dhe vlerëson nevojën që ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon.<br>- Dallon lidhjet që ai/ajo ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë dhe njerëzit e familjes.<br>- Dallon dhe të vlerëson atë çfarë ai/ajo mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon.<br>Unë kam nevojë për të tjerët.<br>- Dallon dhe vlerëson nevojën që ai/ajo ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon.<br>- Dallon dhe vlerëson atë çfarë ai/ajo mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon.</td><td></td><td></td></tr>
</table>

| | | | |
|---|---|---|---|
| | - Dallon lidhjet që ai/ajo ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë dhe shokët (në shkollë e jashtë saj)<br>- sendet me të cilat ka lidhje<br>në jetën e përditshme,<br>- mjedisi etj.<br>**Nevojat dhe dëshirat.**<br>- Shpreh nevojat dhe dëshirat e tij/saj;<br>- Dallon nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë.<br>**Veprimtari**<br>**Luaj me trenin e ëndrrave.**<br>- Shpreh nevojat dhe dëshirat e tij/saj.<br>- Dallon nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë.<br>- Jep një shpjegim për këto ndryshime, për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij/saj dhe të tjerëve etj.<br>**Unë jam fotoreporter.**<br>- Vendos veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe e sheh veten si pjesë e tij/saj.<br>- Shpreh përgjegjësinë e tij/saj ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.<br>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale. | | |
| **Tematika 1: Individët, grupet, shoqëria.**<br><br>**Të bashkëveprojmë**<br>**Orë të sugjeruara: 10 orë.** | **Çfarë është respekti?**<br>- Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.<br>- Beson te vetja dhe te të tjerët.<br>**Rolet e mia në familje.**<br>- Dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në familje.<br>- Vlerëson rolin e tij/saj dhe të të tjerëve në familje.<br>- Bashkëvepron me të tjerët në familje për të zgjidhur probleme të ndryshme.<br>**Rolet e mia në klasë.**<br>- Dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në klasë.<br>- Vlerëson rolin e tij/saj dhe të të tjerëve në klasë.<br>- Bashkëvepron me të tjerët në<br>klasë për të zgjidhur probleme të ndryshme. | **Grupet në shkollë.**<br>- Dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në grup.<br>- Vlerëson rolin e tij/saj dhe të të tjerëve në grup.<br>- Bashkëvepron me të tjerët në grup për të zgjidhur probleme të ndryshme.<br>**Shoku dhe shoqja ime.**<br>- Dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri.<br>- Vlerëson rolin e tij/saj dhe të të tjerëve në shoqëri.<br>- Bashkëvepron me të tjerët në shoqëri për të zgjidhur probleme të ndryshme. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **Unë jam vullnetar.**<br>- Pranon që ka njerëz që kanë vështirësi për të kuptuar dhe për të bërë gjëra të ndryshme dhe të tregojë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata/ato etj.<br>**Unë dhe i panjohuri.**<br>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.<br>- Bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme.<br>**Unë dhe mjedisi.**<br>- Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë.<br>- Bashkëvepron me të tjerët në grup për të zgjidhur probleme të ndryshme.<br>**Veprimtari: Mësoj duke luajtur.**<br>- Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.<br>- Flet për rëndësinë e punës së përbashkët, për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata/ato bëjnë pjesë.<br>- Vlerëson rolin e tij/saj dhe të tjerëve në familje, klasë, grup, lagje etj.<br>**Unë jam fotoreporter.**<br>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.<br>- Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.<br>- Beson te vetja dhe te të tjerët<br>- Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Tematika 2:**<br>**Pushteti, autoriteti, qeverisja.**<br><br>**Rregullat**<br>**Orë të sugjeruara:**<br>**4 orë**<br><br>**Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe në park**<br>**Orë të sugjeruara:**<br>**4 orë** | | **Rregullat e klasës.**<br>- Dallon rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë.<br>- Pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar.<br>- Vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme.<br>**Rregullat në shkollën tonë.**<br>- Vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij/saj të përditshme.<br>- Diskuton për rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë etj.<br>**Rregullat në komunitet.**<br>- Dallon rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në komunitet.<br>- Pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar.<br>- Respekton rregullat në çdo fushë të veprimtarisë.<br>**Siguria në rrugë.**<br>- Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor;<br>- Identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij/saj në rrugë.<br>**Higjiena ime.**<br>- Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave higjienës<br>- Demonstron gatishmërinë e tij/saj për të ndjekur rregullat e higjienës në veprimtaritë e përditshme në familje, klasë, shkollë etj. | **Të shëndetshëm**<br>- Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave për të patur shëndet të mirë.<br>**Rreziqet në shtëpi.**<br>- Identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij/saj në shtëpi.<br>- Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të sjelljes në shtëpi;<br>**Unë jam fotoreporter.**<br>- Identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij në mjedise publike.<br>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.<br>- Flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të sjelljes në mjedise publike.<br>**Familjet tona.**<br>- Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet familjeve;<br>- Rendit disa prej punëve dhe shërbimeve që individët dhefamiljet mund të bëjnë për komunitetin;<br>- Tregon rëndësinë e punës së përbashkët të individëve dhe të familjeve për lagjen ku banojnë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi**<br><br>**Familja ime**[2]<br>**Orë të sugjeruara: 7 orë** | | | **Nevojat dhe dëshirat e familjeve tona.**<br>- Dallon dhe grupon nevojat dhe dëshirat;<br>- Përshkruan ndryshimin ndërmjet një nevoje dhe një dëshire;<br>- Vendos përparësitë e duhura në zgjedhjen e nevojave dhe të dëshirave.<br>**Profesionet.**<br>- Përkufzon fjalët punë/profesion/biznes dhe sipërmarrës<br>- Identifikon punën që kryejnë njerëz të ndryshëm;<br>- Analizon aftësitë e nevojshme për të përcaktuar mënyrën si të mbështesin pjesëtarët e familjes.<br>**Bizneset në lagjen tonë.**<br>- Lexon simbolet në hartë;<br>- Identifikon mallrat ose shërbimet e ofruara nga bizneset;<br>- Vlerëson shkallën e plotësimit të nevojave dhe të dëshirave nga bizneset e lagjes ose të komunitetit.<br>**Biznesi ynë i ri.**<br>- Përshkruan një nga karakteristikat sipërmarrëse;<br>- Plotëson një nevojë ose një dëshirë;<br>- Planifikon hapjen e një biznesi të ri.<br>-<br>**Veprimtari:**<br>**Biznesi ynë.**<br>- Tregon me veprime praktike si njerëzit jetojnë dhe punojnë së bashku në një familje;<br>- Vlerëson rolin e tij dhe të tjerëve në familje, grup, etj.<br>**Unë jam fotoreporter.**<br>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale në bizneses e lagjes.<br>- Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.<br>- Flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë. |

[2] Këto tema mësimore janë përgatitur nga Junior Achivement .

## Planifikimi 3 mujor i lëndës : Shtator – Dhjetor

**13 orë**

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2 7.1[2]

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

- Identifikon rolet si shembull i sjelljeve të të nxënit të tij në situatat e grupit, si : nxënës, anëtar familje, anëtar i barabartë i grupit në një lojë, ose anëtar i klubeve të ndryshme shkollore.
- Jep shembuj të grupeve dhe tregon ndikimin e ligjeve dhe rregullave. Nga ana tjetër ai tregon ndikimet moshatarëve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet kulturorë p.sh rregullat e klasës, të shkollës, të komunitetit.
- Identifikon shembuj të konflikteve ndërmjet grupeve, individëve ose institucioneve, si dhe ndërmjet besimit individual dhe ligjeve, rregullave dhe praktikave qeverisëse në shkollë, familje dhe komunitet.
- Tregon grupe dhe institucione që punojnë për plotësimin e nevojave individuale, si dhe për sigurimin e të mirave të përbashkëta, duke identifikuar edhe shembuj për "studim rasti" kur këto grupe dhe institucione nuk punojnë në këtë drejtim.

| Nr. | Kompetenca/ Tematika (13 orë) | Temat mësimore | Situatat e parashikuara të të nxënit | | | Për çfarë do të vlerësohen nxënësit | Burimet e informacionit | Mjetet/materialet mësimore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Pyetja kërkimore** | **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | **Mjedisi fizik** | | | |
| 1. | **INDIVIDËT, GRUPET, SHOQËRIA**<br><br>**Unë dhe të tjerët**<br><br>**Orë të sugjeruara: 10 orë** | **Kush jam unë?** | Kush jam unë? | Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br>Puna në grup dhe puna individuale;<br>Mësoj duke kërkuar;<br>Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br>Zbatime praktike;<br>Metoda integruese;<br>Bashkëbisedim;<br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për prezantimet dhe veprimtaritë e realizuara.<br>-Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës. | Teksti i nxënësit, adresa e internetit www.Bashkia....., Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. | Çertifikatë, pashaportë, foto të nxënësve |

[3] I referohet tabelës 1

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë e realizuara. | | |
| 2. | | **Ku banoj unë?** | Cila është adresa ime? | Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë prezantimeve si dhe punët e tyre.<br><br>-Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë 1 & 2 . | Teksti i nxënësit, www. (qyteti) .com | Hartë e Shqipërisë, hartë e lagjes, foto etj. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | | **Unë kam të drejta.** | Çfarë të drejtash kam unë? | Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna individuale e pavarur;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Brenda / Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë prezantimeve si dhe punët e tyre në vëprimtarinë 1&2<br><br>-Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë 1 & 2. | Teksti i nxënësit, të drejtat e njeriut, DUDNj, KDF, situata me Studim rastie për diskriminimin gjinor. | Fotografi, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | **Unë marr përgjegjësi.** | Sa i përgjegjshëm jam unë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Puna individuale e pavarur;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet të tyre në një situatë;<br><br>✓ Për kryerjen e saktësisë së punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre në zgjidhjen e situatave.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, | Foto, albume. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | | **Unë kam një ëndërr...** | Cilat janë ëndrrat e mia**?** | Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna individuale e pavarur;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njeri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Për bashkëpunimin në grup;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | | **Familja ka nevojë për mua.** | Pse familja ka nevojë për mua ? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br>Puna individuale e pavarur;<br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Zbatime praktike;<br>Bashkëbisedim;<br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br>Nxënësit vlerësojnë njeri -tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Për qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë diskutimit;<br>✓ Për punët e tyre individuale dhe prezantimet.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2:<br>✓ Prezantimet;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, DTNJ, KDF | Foto, albume, etj. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | | **Unë kam nevojë për të tjerët.** | Përse kam nevojë për të tjerët**?** | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Punë e pavarur individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Foto, albume, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | | **Nevojat dhe dëshirat.** | Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia për të qenë i lumtur dhe i shëndetshëm? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Punë e pavarur individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njeri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Për qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë diskutimit;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale dhe prezantimet.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2:<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ. | Foto, albume, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | | **Veprimtari: Luaj me trenin e ëndrrave.** | | Kërkimi ndërmjet dialogut formues<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Për qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë diskutimit;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale dhe prezantimet.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, respektimit të drejtës së fjalës së njëri-tjetrit, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në plotësimin e veprimtarisë “Treni i ëndrrave”<br><br>✓ Prezantimet ;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. | Fletët ngjitëse |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | **Unë jam fotoreporter.** | Çfarë mësoj unë nga të tjerët? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/ Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Për llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre individuale ,në dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale, në punë dyshe apo në grup për:<br>✓ Fotot.<br>✓ Produktin e shkruar.<br>✓ Prezantimet .<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Aparat fotografik |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11. | **INDIVIDËT, GRUPET, SHOQËRIA**<br><br>**Të bashkëveprojmë**<br><br>**Orë të sygjeruara:**<br><br>**3 Orë** | **Çfarë është respekti?** | Si tregojmë respekt? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre individuale ,në dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët .<br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br>✓ Punët individuale dhe në punë dyshe në veprimtaritë 1-3 ;<br>✓ Prezantimet individuale dhe ato në punë dyshe;<br>✓ Produktin e shkruar në veprimtarinë 3;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, video me situata**.** | Foto, albume, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12. | | **Rolet e mia në familje.** | Pse janë të rëndësishme rolet e mia në familje? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive,<br><br>bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Punë e pavarur individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet dhe komentet e këtyre gjatë diskutimeve;<br><br>✓ Prezantimin e punës .<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët .<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale dhe ato me shokun e bankës për :<br><br>✓ Prezantimet e punës ;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume familjare |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13. | | **Rolet e mia në klasë.** | Pse janë të rëndësishme rolet e mia në klasë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Punët e tyre individuale;<br><br>✓ Përmbushjen e roleve;<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit në marrëdhënie me të tjerët.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale në veprimtaritë 1& 2 ;<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;<br><br>✓ Për përmbushjen e roleve të tyre. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Foto, albume, , |

## Planifikimi 3 mujor i lëndës : Janar – Mars — 12 orë

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2 7.1 7.2[3]

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

- Identifikon rolet si shembull i sjelljeve të të nxënit të tij në situatat e grupit, si : nxënës, anëtar familje, anëtar i barabartë i grupit në një lojë, ose anëtar i klubeve të ndryshme shkollore.
- Jep shembuj të grupeve dhe tregon ndikimin e ligjeve dhe rregullave. Nga ana tjetër ai tregon ndikimet moshatarëve te njerëzit, ngjarjet dhe elementet kulturorë p.sh. rregullat e klasës, të shkollës, të komunitetit.
- Identifikon shembuj të konflikteve ndërmjet grupeve, individëve ose institucioneve, si dhe ndërmjet besimit individual dhe ligjeve, rregullave dhe praktikave qeverisëse në shkollë, familje dhe komunitet.
- Tregon grupe dhe institucione që punojnë për plotësimin e nevojave individuale, si dhe për sigurimin e të mirave të përbashkëta, duke identifikuar edhe shembuj për “studim rasti” kur këto grupe dhe institucione nuk punojnë në këtë drejtim.
- Dallon të drejta dhe përgjegjësi individuale në grupin social ku jeton, si: familja, bashkëmoshatarët, klasa, shkolla.
- Jep shembuj se si sigurohen nevojat dhe dëshirat e njerëzve në niveleve të ndryshme si familja e komuniteti.
- Shpjegon se individët dhe grupet ku ata bëjnë pjesë duhet të pranojnë diversitetin, për të ruajtur marrëdhënie miqësore me qëllim që sigurohet paqja dhe jetesa paqësore.
- Dallon shkallë të ndryshme qeverisjeje nga klasa, shkolla e bashkësia dhe identifikon disa persona përgjegjës në çdo nivel.
- Dallon faktorët që kontribuojnë për bashkëpunimin ndërmjet nxënësve dhe grupimeve që dallohen në shkollë dhe në lagje dhe disa nga shkaqet e konflikteve ndërmjet tyre.
- Përshkruan ndryshimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave individuale dhe të grupeve dhe jep mendimin e vet për koncepte të tilla si: drejtësi, paanësi, ndershmëri.

<table>
<tr><th rowspan="2">Nr.</th><th rowspan="2">Kompetenca/<br>Tematika<br>(12 orë)</th><th rowspan="2">Temat mësimore</th><th colspan="3">Situatat e parashikuara të të nxënit</th><th rowspan="2">Për çfarë<br>do të vlerësohen nxënësit</th><th rowspan="2">Burimet<br>e informacionit</th><th rowspan="2">Mjetet/materialet mësimore</th></tr>
<tr><th>Pyetja kërkimore</th><th>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</th><th>Mjedisi fizik</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>INDIVIDËT, GRUPET, SHOQËRIA<br><br>Të bashkëveprojmë<br><br>Orë të sugjeruara:<br><br>7 orë</td><td>Grupet në shkollë</td><td>Pse grupet janë të rëndësishme?</td><td>Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Punë e pavarur individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar ;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi.</td><td>Brenda/<br><br>Jashtë klase</td><td>Vlerësim formues<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Komentet dhe diskutimet;<br><br>✓ Punët e tyre në grup dhe individualisht.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit gjatë punës në grup.<br><br>Vlerësim përmbledhës<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Punët individuale në veprimaritë 1& 2;<br><br>✓ Bashkëpunim e punës në grup;<br><br>✓ Prezantimet e punës në grup dhe individualisht;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit.</td><td>Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ</td><td>Foto, albume</td></tr>
</table>

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | | **Shoku dhe shoqja ime** | Si të zë një shok ose një shoqe? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Punë individuale në grup;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike ;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve<br><br>✓ Për plotësimin e " Murit të miqësisë"<br><br>Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Prezantimin e punës së " Murit të miqësisë"<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Foto, albume, Pazëlla |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | | **Unë jam vullnetar** | Si të ndihmoj njerëzit në vështirësi? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/ Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve<br><br>✓ Për plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës.*<br><br>Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ, www.kryqi i kuq shqiptar.org | Foto, albume |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | | **Unë dhe i panjohuri** | Si të sillem me një të panjohur? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br>Punë individuale e pavarur;<br>Mësoj duke kërkuar ;<br>Bashkëbisedim;<br>Zbatime praktike;<br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues.*<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve<br>✓ Për plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1& 2.<br><br>Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>Vlerësohen nga mësuesi për:<br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1&2;<br>✓ Bashkëveprimin me njëri-tjetrin në punë dyshe;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | | **Unë dhe mjedisi** | Si mund të mbroj mjedisin? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Punë individuale e pavarur;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit/et vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve;<br><br>✓ Për veprimet e tyre në mbrojtje të mjedisit;<br><br>✓ Për zhvillimin e veprimtarive 1-3.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës.*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1- 3;<br><br>✓ Bashkëveprimin me njëri-tjetrin në punë dyshe;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit.<br><br>-Mësuesi/mësuesja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve . | Teksti i nxënësit,www.rec.org | Foto, albume, Objekte me materiale të riciklueshme |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | | **Veprimtari: Mësoj duke luajtur** | | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formue.*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë lojës për:<br><br>✓ Zgjidhjen e situatave të etiketave të testit;<br><br>✓ Për kryerjen e veprimeve sipas kërkesave të lojës.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, bashkëpunimin dhe kryerjen e veprimtarive të lojës.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Zhvillimin e lojës në grup;<br><br>✓ Kryerjen e veprimeve sipas kërkesave të lojës. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Zar, petëza me ngjyra |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | | **Unë jam fotoreporter** | Si bashkëveproj me të tjerët? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Për llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë; veprimtarisë<br>✓ Për punët e tyre individuale ,në dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët .<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale , në punë dyshe apo në grup për :<br>✓ Fotot;<br>✓ Produktin e shkruar;<br>✓ Prezantimet ;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume,<br><br>Aparat fotografik, kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | **PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA**<br><br>RREGULLAT<br><br>Orë të sugjeruara:<br><br>5 orë | **Rregullat e klasës** | Pse duhet të zbatoj rregullat në klasë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Punë individuale e pavarur;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit/et vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve për zbatimin e rregullores;<br><br>✓ Për zbatimin e rregullores së klasës.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre dhe komentet e tyre.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1&2;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e punës së njëri-tjetrit;<br><br>✓ Për zbatimin e rregullores së klasës. | Teksti i nxënësit | Foto, albume,<br><br>Kompjuter , videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | | **Rregullat në shkollën tonë** | Përse duhen rregullat në shkollë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Punë e pavarur individuale;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>Nxënësit/et vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve për zbatimin e rregullores së shkollës;<br><br>✓ Për zbatimin e rregullores së shkollës.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre dhe komentet e tyre.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1-3;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e punës së njëri-tjetrit;<br><br>✓ Për zbatimin e rregullores së shkollës. | Teksti i nxënësit | Foto, albume |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | **Rregullat në komunitet** | Pse komuniteti ka nevojë për rregulla? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>Nxënësit/et vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve rreth zbatimit të rregullave në komunitet;<br><br>✓ Për kryerjen e veprimtarisë 1-3.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre rreth zbatimit të rregullave në komunitet<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>✓ Kryerjen e punës në veprimtarinë 1-3;<br><br>✓ Qëndrimet, komentet dhe vlerësimin e punës së njëri-tjetrit;<br><br>✓ Për zbatimin e rregullave në komunitetin ku jetojnë. | Teksti i nxënësit | Foto, albume,<br><br>Kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11. | | **Siguria në rrugë** | Si të eci i sigurt në rrugë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit/et vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Gjatë komenteve dhe diskutimeve për zbatimin e rregullave të qarkullimit;<br><br>✓ Për kryerjen e veprimtarive 1&2.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre dhe komentet e tyre dhe velerësimin e njëri- tjetri<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>Prezantimin e punës në veprimtarinë 1&2. | Teksti i nxënësit | Foto, albume,<br><br>Kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12. | | **Higjiena ime** | Si të mbaj një higjienë të mirë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri -tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Mbajtjen e një higjiene të mirë;<br><br>✓ Për komentet dhe diskutimet;<br><br>✓ Për plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Mbajtjen e një higjiene të mirë;<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1&2;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Foto, albume,<br><br>Mjetet e kutisë së ndihmës së shpejtë |

## Planifikimi 3 mujor i lëndës : Prill – Qershor

**10 orë**

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2 7.1 7.2[4]

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës**

- ✓ Dallon të drejta dhe përgjegjësi individuale në grupin social ku jeton, si: familja, bashkëmoshatarët, klasa, shkolla.
- ✓ Jep shembuj se si sigurohen nevojat dhe dëshirat e njerëzve në niveleve të ndryshme si familja e komuniteti
- ✓ Shpjegon se individët dhe grupet ku ata bëjnë pjesë duhet të pranojnë diversitetin, për të ruajtur marrëdhënie miqësore me qëllim që sigurohet paqja dhe jetesa paqësore.
- ✓ Dallon faktorët që kontribuojnë për bashkëpunimin ndërmjet nxënësve dhe grupimeve që dallohen në shkollë dhe në lagje dhe disa nga shkaqet e konflikteve ndërmjet tyre.
- ✓ Zbulon si njerëzit në një familje janë të ngjashëm dhe të ndryshëm, si ata punojnë së bashku për një jetë më të mirë.
- ✓ Përshkruan ndryshimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave individuale dhe të grupeve.
- ✓ Diskuton për rëndësinë që ka puna,për të paguar për nevojat dhe dëshirat tona.
- ✓ Identifikon personazhe, që planifikojnë të fitojne para, thotë me fjalët e tij ç'është paraja dhe dallon monedhën si një nga format e parasë.
- ✓ Zbulon që njerëzit kanë parapëlqime të ndryshme dhe bëjnë zgjedhje të ndryshme.

| Nr. | Kompetenca/<br>Tematika<br>( 10 orë) | Temat mësimore | Situatat e parashikuara të të nxënit | | | Për çfarë<br>do të vlerësohen nxënësit | Burimet<br>e<br>informacionit | Mjetet/<br>materialet<br>mësimore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Pyetja kërkimore** | **Metodologjia<br>Dhe veprimtaritë e nxënësve** | **Mjedisi<br>fizik** | | | |
| 1. | **PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA**<br><br>RREGULLAT<br><br>Orë të sugjeruara:<br>3 orë | **Të shëndetshëm** | Si të kem shëndet të mirë? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Punë e pavarur individuale ;<br><br>Mësoj duke kërkuar ;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:<br>✓ Komentet dhe pyetjet që i drejtojnë njëri tjetrit;<br>✓ Për plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1- 4.<br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet, argumentet e sjella gjatë diskutimeve dhe mënyrën e të shprehurit.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1-4;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri/ra- tjetrit/ës. | Teksti i nxënësit,<br>Libri IZHA 2012.” Për një ushqyerje të shëndetshme” KDF,DUDNJ | Foto, albume, Mjete të kuzhinës si lugë, pirun, thikë, pecetë etj. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | | **Rreziqet në shtëpi** | Pse duhet të jem i kujdesshëm në shtëpi? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet, argumentet dhe komentet që bëjnë gjatë diskutimeve;<br><br>✓ Për kryerjen dhe prezantimin e veprimtarisë 1&2.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet, argumentet e sjella gjatë diskutimeve dhe mënyrën e të shprehurit dhe respektimin e mendimeve të njëri/a- tjetrit/ës.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi/ja për:<br><br>✓ Prezantimin e punës në veprimtarinë 1&2;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri/ra-tjetrit/ës. | Teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ | Foto, albume, Kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | | **Unë jam fotoreporter** | Si duhet të sillem në mjediset publike? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Për llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre individuale , në dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale , në punë dyshe apo në grup për<br>✓ Fotot;<br>✓ Produktin e shkruar;<br>✓ Prezantimet ;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume, Aparat fotografik, kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **4.** | | **Familjet tona** | Çfarë dua të bëj më mirë unë dhe familja ime? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna individuale dhe puna në grup;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Prezantimi. | Në klasë | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre individuale apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale ,apo në grup për:<br>✓ Prezantimet;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, Postera, albume |
| | PRODHIMI, SHPËRNDARJA DHE KONSUMI<br><br>Orë të sugjeruara:<br><br>Familjet tona<br><br>7 orë | | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | | **Nevojat dhe dëshirat e familjeve tona** | Cilat janë nevojat dhe dëshirat e familjes sime? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/<br><br>Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale, dyshe apo në grup.<br><br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Punët individuale, dyshe, apo në grup;<br><br>✓ Prezantimet;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | | **Profesionet** | Çfarë dëshiroj të bëhem kur të rritem? | Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi . | Brenda/ Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale, dyshe apo në grup;<br><br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Punët individuale, dyshe, apo në grup;<br><br>✓ Prezantimet<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | | **Bizneset në lagjen tonë** | Çfarë mallra dhe shërbime ofrojnë bizneset në lagjen time? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/ Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet dhe<br><br>komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br><br>✓ Për punët e tyre<br><br>Individuale, dyshe apo në grup;<br><br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br><br>✓ Punët individuale, dyshe, apo në grup;<br><br>✓ Prezantimet ;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume, Hartë e lagjes etj. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | | **Biznesi ynë i ri** | Çfarë biznesi duhet të hap unë në lagjen time? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda / Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br><br>✓ Qëndrimet dhe<br><br>komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br><br>✓ Për punët e tyre individuale , në dyshe apo në grup;<br><br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br><br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br><br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale , në punë dyshe apo në grup për :<br><br>✓ Produktin e shkruar;<br><br>✓ Prezantimet ;<br><br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto, albume |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | | **Veprimtari: Biznesi ynë** | | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna dyshe ose në grup;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda/ Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br><br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Qëndrimet dhe komente e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre në dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimin e punës së tyre.<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Veprimtarikë e kryera<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br><br>-Vlerësohen nga mësuesi për:<br>✓ Punët individuale , në punë dyshe apo në grup;<br>✓ Prezantimet e biznesit të tyre;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njeri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Foto,albume, fletëpalosje, postera etj. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | **Unë jam fotoreporter** | Çfarë punësh bëjnë njerëzit për të siguruar të ardhurat e tyre? | Kërkimi ndërmjet dialogut formues;<br><br>Metoda interaktive; bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>Puna në grup dhe puna individuale;<br><br>Mësoj duke kërkuar;<br><br>Bashkëbisedim;<br><br>Zbatime praktike;<br><br>Prezantimi. | Brenda / Jashtë klase | *Vlerësim formues*<br>-Nxënësit vlerësojnë njëri - tjetrin gjatë orës për:<br>✓ Për llojet e pyetjeve që parashtrojnë;<br>✓ Qëndrimet dhe<br>komentet e tyre gjatë veprimtarisë;<br>✓ Për punët e tyre individuale;<br>✓ Prezantimin epunës së<br>tyre.<br>-Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:<br>✓ Llojet e pyetjeve që parashtrojnë<br>✓ Qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerë.<br><br>*Vlerësim përmbledhës*<br>-Vlerësohen nga mësuesi për punët individuale , në punë dyshe apo në grup për<br>✓ Fotot;<br>✓ Produktin e shkruar;<br>✓ Prezantimet ;<br>✓ Komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit. | Teksti i nxënësit | Aparat fotografik, Foto, albume etj |

# Modele mësimi

| Fusha: | Lënda: | Shkalla: | Tematika: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | "Edukim për shoqërinë" | I | Individët, grupet, shoqëria. |

# 1. Kush jam unë?

**Situata e të nxënit[1]**

**Pyetja kërkimore:**

Kush jam unë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

**Nxënësi/ja:**

- shpreh tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët/at;
- dallon tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai/ajo jeton.

**Fjalori:**

emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi, çertifikatë personale.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet, matematika. | - të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, adresa e internetit: www............gov.al, bashkia, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. | çertifikatë, pasaportë, foto të nxënësve/eve, top. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në figurat e mësimit dhe të dhënat e tyre, trajtohen çështje të nxënësve/eve romë/e, egjiptianë/e dhe të respektimit të të drejtave të tyre.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

"Kush jam unë?" është pyetja që individi ia drejton shpeshherë vetes gjatë jetës. Njeriu është një individualitet i papërsëritshëm, unik dhe është detyra jonë që ta pranojmë tjetrin ashtu siç është.

Individi është një tërësi "kuptimesh" që ai/ajo vetë ka për marrëdhëniet me të djeshmen e tij/saj, të tashmen, si percepton të ardhmen, si menaxhon suksesin, dështimin, si përzgjedh dëshirat, si grupon detyrat, si përcakton përparësitë, si ndjehet me identitetin dhe përkatësinë gjinore.

Lexohet gjëegjëza dhe ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për gjetjen e fjalës enigmë të gjëegjëzës.

Mësuesi/ja i jep një top njërit/ës prej nxënësve/eve, duke i kërkuar prezantimin e emrit, të mbiemrit dhe të shtetësisë së tij/saj. Topi kalon te të gjithë fëmijët, të cilët ia pasojnë me radhë njëri-tjetrit.

Nxënësit/et prezantojnë veten, dëgjojnë prezantimet e shokëve/shoqeve.

Ata/ato shprehin mendimet e tyre rreth situatës kur nuk njohin të dhënat e tyre personale. Diskutohet rubrika **Veprim – Pasojë**. Theksohet fakti se çdo veprim i yni ka një pasojë. I gjithë libri ka parimin **Veprim – Pasojë**. Mësuesi/ja duhet të theksojë hapat e veprimeve të fëmijëve dhe pasojat e tyre, të cilat mund të jenë pozitive ose negative.

Unë nuk e di shtetësinë. – Unë qortohem nga familja, mësuesi/ja dhe shokët/shoqet.

[1] Situata e të nxënit është veprimtaria që realizohet në mjediset: → "Komunikimi dhe të shprehurit"; → "Shiko dhe lexo"; → "Mësoj duke kërkuar"

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et të vizatojnë portretin e tyre. Duke ditur se emri është rastësor, konvencial, jorastësor, mësuesi/ja nxit diskutimin mbi marrëdhëniet që nxënësit/et kanë me emrin. Secili/a tregon se çfarë do të thotë emri që mban, kush ia ka vënë, nëse do të donte të kishte një emër tjetër etj. Nxënësit/et duhet ta dinë se ekziston një ligj që përmbush kërkesën për të ndërruar emrin nëse nuk u pëlqen. Ata/ato shprehin mendimet e tyre rreth emrit. Mësuesi/ja u shpërndan të gjithëve certifikatat e fotokopjuara.

Nxënësit/et plotësojnë të dhënat e tyre për të demonstruar të kuptuarit e fjalëve, duke i shprehur ato me shkrim sipas formatit të dhënë në libër dhe duke u ndihmuar nga çertifikata e dhënë.

Pas përfundimit të veprimtarisë, nxënësi/ja bën prezantimin e tij/saj (me dëshirë) dhe nxënësit/it e tjerë/a ftohen të japin mendime dhe të komentojnë rreth punës së shokut/shoqes.

**Veprimtaria 2**. Nxënësit/et ftohen të vërejnë fotografinë e festimit të datëlindjes. Ata/ato lexojnë së bashku me mësuesin/en dhe duke u bazuar në të dhënat e figurës plotësojnë me shkrim se sa vjeç është vajza që po feston datëlindjen. Nxënësit/et tregojnë rreth festimit të datëlindjes së tyre.

**Veprimtaria 3**. Mësuesi/ja e ndan klasën në tre grupe sipas rreshtave dhe u jep një letër në formë fizarmonike, të cilën secili/a duhet t'ia pasojë shokut/shoqes në krahun e djathtë të tij/saj. Çdo fëmijë shkruan aty vendlindjen.

Së bashku me mësuesin/en i rendisin sipas rendit alfabetik në tabelën e klasës.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e librit dhe bashkë me ta lexohen fjalitë poshtë fotove. Diskutohet rreth pamjes fizike të çdo fëmije, rreth tipareve që i dallon ata nga njëri-tjetri dhe lexohen prezantimet e tyre.

Më pas nxënësit/et ftohen të vërejnë çertifikatën.

Shpjegohet fjala çertifikatë dhe përdorimi që ajo ka.

Diskutohet dhe shpjegohet rreth elementeve përbërëse të saj, të tillë si: datëlindje, vendlindje, shtetësi etj.

### PËRMBYLLJE

Ftohen nxënësit/et që të bëjnë një prezantim të vetes, duke përdorur fjalorin e mësuar.
Pas prezantimeve diskutohet rubrika "Unë" për Veprim – Pasojën.

Unë e di vendlindjen dhe shtetësinë time.
↓
Unë vlerësohem nga familja dhe mësuesi/ja.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën për prezantimet dhe veprimtaritë e realizuara.
Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.
*Vlerësim përmbledhës*:
Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë e realizuara.

### DETYRË SHTËPIE

Detyrat e shtëpisë jepen, duke u bazuar në rezultatet e nxënësve/eve gjatë orës. Ftohen nxënësit/et të gjejnë sa shokë/shoqe të pallatit kanë të njëjtën vendlindje.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 2. Ku banoj unë?

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**
Cila është adresa ime?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**
1.1 1.2 1.3 2.1 2.2 3.3 3.5 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja vendos veten në një mjedis të caktuar (lagje, qytet, fshat, shtet etj.) dhe e sheh veten si pjesë të tij.

**Fjalori:**
adresë, rrugë, qytet, fshat, vendbanim.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, gjeografi, arte, matematikë. | - mjedisi |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es. | hartë e Shqipërisë, hartë e lagjes, foto etj. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në kushtet e klasës, diskutimet e nxënësve/eve dhe shembujve, trajtohen të drejtat e fëmijëve apo probleme që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, gjinor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Bashkëbisedohet me nxënësit/et rreth banimit të tyre. Lexohet situata e fëmijës që ka humbur rrugën. Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth problemit të djalit dhe si do ta zgjidhë djali problemin. Gjithmonë duke e lidhur me përvojat e nxënësve/eve nga jeta e tyre e përditshme.

Nxënësit/et punojnë në çift me shokun e bankës ku prezantojnë adresën e shtëpisë së shokut/shoqes të tyre me gojë.

Mësuesi/ja ngre nxënësit/et që dëshirojnë të tregojnë adresën e tyre dhe pyet se çfarë mund të ndodhë në rast se ata/ato nuk e dinë adresën e tyre.

Më pas vazhdohet me teknikën "stuhi mendimi", duke pyetur nxënësit/et se çfarë nënkuptojnë ata/ato me fjalën "adresë". Shkruhen fjalët kyçe që dalin nga mendimet e fëmijëve në dërrasë, si: vendbanim, adresë, etj. dhe shpjegohet kuptimi i tyre.

Diskutohet rubrika **Veprim – Pasojë**.

Unë nuk e mbaj mend adresën time. **–** Unë humbas rrugën. Mësues/i/ja jep një zgjidhje të këtij problemi, duke thënë se në një rast të tillë duhet t'i drejtohemi mikut/es më të mirë që është punonjësi/ja i/e policisë.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et që të vërejnë skicën e lagjes ku banon Blerta. Ata/ato gjejnë në hartën-skicë shtëpinë e Blertës, duke u bazuar në të dhënat e adresës së saj.

**Veprimtaria 2**. Nxënësit/et ftohen të vërejnë hartën-skicë të Shqipërisë. Ata/ato ngjyrosin në hartë vendlindjen e tyre dhe vendlindjen e shokut/shoqes së bankës. Mësuesi/ja thekson ndryshimin që ekziston midis vendbanimit dhe vendlindjes.

**Veprimtaria 3.** Nxënësit/et çohen në këmbë të gjithë, gjejnë shokët/shoqet që kanë të njëjtën vendlindje dhe shkruajnë emrat në një letër. Mësuesi/ja së bashku me një nxënës/e përcakton grupin më të madh të nxënësve/eve.

Nxënësit/et duke u bazuar në elementet e adresës që mësuan, plotësojnë me shkrim adresën e tyre. Ata/ato ftohen të bëjnë prezantimin e punëve të tyre dhe të bëjnë komente rreth punëve të shokëve/shoqeve.

### PËRMBYLLJE

Pas prezantimeve diskutohet rubrika "Unë" për **Veprim –Pasojën**.

Unë e mbaj mend adresën time.

↓

Unë nuk humbas vendbanimin.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e librit. Lexohet adresa e Arbrit dhe e vajzës në fshat. Diskutohen elementet përbërëse të adresës në qytet dhe në fshat. Realizohet një diagram i Venit për adresën e fshatit dhe të qytetit.

Mësuesi/ja paraqet hartën e Shqipërisë me qytetet dhe fshatrat kryesore, në përputhje me fëmijët e klasës. Shpjegohen fjalët e fjalorit, si: rrugë, qytet, fshat, hartë, shtet.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë prezantimeve si dhe punët e tyre. Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës së mësimit.
*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2.

### DETYRË SHTËPIE

Duke u bazuar në rezultatet e të nxënit të nxënësve/eve, gjatë orës jepen detyra shtëpie individuale në lidhje me plotësimin e adresës së tyre.

| Fusha: | Lënda: | Shkalla: | Tematika: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | "Edukim për shoqërinë" | I | Individët, grupet, shoqëria. |

# 3. Unë kam të drejta

**Situata e të nxënit**

**Pyetja:**
Çfarë të drejtash kam unë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**:
1.1 1.3 2.1 2.3 3.4 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- vlerëson mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve/ave.

**Fjalori:** e drejtë, familje, përgjegjësi, keqtrajtim.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, edukim fizik, sporte dhe shëndet, arte. | - të drejtat e fëmijëve;<br>- mjedisi. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, situata me raste të diskriminimit gjinor. | fotografi, video, albume etj. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në figurat e mësimit diskutimet dhe shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et nga jeta reale, trajtohen të drejtat e fëmijëve dhe problemet e tyre.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ftohen nxënësit/et të vërejnë foton e librit ku shtatë fëmijë duan të luajnë futboll. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre se si duhet të veprojnë fëmijët që të luajnë të gjithë. Mësuesi/ja thekson se pavarësisht numrit tek të fëmijëve, gjithkush duhet të luajë, duke marrë përsipër një rol që ai/ajo dëshiron (arbitër, ndihmës arbitër, trajner etj.). Pyeten nxënësit/et nëse u ka ndodhur të jenë përjashtuar nga loja për arsye të ndryshme nga shokët/shoqet, mësuesja etj. dhe si janë ndier.

Shpjegohet fjala *të drejta*, të cilat janë tërësia e sjelljeve që njerëzit janë të lirë të bëjnë. Të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë, universale dhe të përjetshme kanë të drejtat e tyre. Të drejtat njerëzore janë të patjetërsueshme. Çdo njeri i gëzon këto të drejta për sa kohë është një qenie njerëzore.

Dokumentet kryesore janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Ftohen nxënësit/et të tregojnë situata të ngjashme nga jeta e tyre.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1**. Lexohen të drejtat e dhëna. Ftohen nxënësit/et të shkruajnë ose të vizatojnë një të drejtë që mendojnë se u mungon.

Pas përfundimit, çdo nxënës/e bën prezantimin e punës së tij/saj, ndërkohë që të tjerët/at ftohen të japin mendime dhe të komentojnë rreth saj.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit/et ngjyrosin figurën ku zbatohen të drejtat. Shpjegohet nga fjalori fjala keqtrajtim.

Mësuesi/ja tregon se çfarë duhet të bëjmë kur keqtrajtohemi nga më të rriturit, në shkollë, shtëpi dhe në lagje.

Me ndihmen e mësueses ftohen nxënësit/et të lexojnë fjalitë poshtë figurave që ngjyrosin dhe të shprehin mendimet e tyre rreth rasteve të paraqitura. Ata/ato shprehin mendimet e tyre duke sjellë shembuj edhe nga jeta e tyre e përditshme.

### PËRMBYLLJE

Në fund mund të zhvillohet një situatë loje e ngjashme me situatën e fillim të mësimit. Kjo në varësi të kushteve të klasës.

Pas prezantimeve diskutohet rubrika "Unë" për **Veprim-Pasojë**.

Unë i njoh të drejtat e mia.

↓

Unë i respektoj të drejtat e tjetrit/ës.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e librit dhe lexohen të drejtat. Me ndihmën e fjalorit shpjegohen fjalë të tilla, si: familje, përgjegjësi, keqtrajtim.

Theksohet se përderisa kemi të drejta, kemi dhe përgjegjësi. Nxënësit/et sjellin shembuj nga jeta e tyre për përgjegjësitë që kanë treguar për veprimet e tyre. Ata/ato ftohen të japin mendime dhe të komentojnë rreth mbajtjes së përgjegjësive.

Diskutohet rubrika **Veprim – Pasojë**. Unë i di të drejtat e mia. – Unë kërkoj të trajtohem në mënyrë të barabartë me të tjerët/at.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë prezantimeve si dhe punët e tyre në veprimtarinë 1 dhe 2.
Vlerësohen me shprehje rreth qëndrimeve të tyre në situatat dhe në diskutimet gjatë orës.
*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësit/et ftohen të vizatojnë një të drejtë që ta respektojnë shokët/shoqet në klasë ose prindërit në shtëpi. Realizohet një galeri me punime të fëmijëve.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 4. Unë marr përgjegjësi

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Sa i/e përgjegjshëm/me jam unë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.6 3.2 3.3 4.2 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- respekton vetveten dhe shpreh me besim qëndrimin e tij/saj;
- shpreh përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve/ave, ndaj mjedisit etj.

**Fjalori:**

të drejta, detyrë, përgjegjësi.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet, shkencat e natyrës. | - të drejtat e fëmijëve;<br>- mjedisi. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, kushtet e klasës, në shembujt e sjellë nga vetë ata/ato, trajtohen çështje që paraqesin tolerancën në veprime, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri-tjetrit, të diversitetit kulturor dhe respektimin e të drejtave të tyre.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Lexohet situata dhe ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth veprimit të Andit. Diskutohet rubrika **Veprim – Pasojë**: Andi harron të ushqejë qenin. – Qeni është i uritur.

Gjatë diskutimit me nxënësit/et shpjegohen fjalët: përgjegjësi dhe detyrë.

Theksohet që: Përgjegjësi është të kryesh një punë sa më mirë. Përgjegjësi është zbatimi i detyrave.

Nxënësit/et tregojnë ngjarje nga jeta e tyre, kur nuk janë treguar të përgjegjshëm/me në veprimet e tyre dhe pasojat që kanë patur. Mësuesi/ja parashtron para nxënësve pyetjen "Sa i përgjegjshëm jam unë?" dhe fton nxënësit/et të bëjnë komente dhe pyetje rreth situatave të treguara nga shokët/shoqet.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et të ngjyrosin në vizatimin e dhënë fëmijët që tregojnë përgjegjësi në kryerjen e veprimeve për të demonstruar të kuptuarit e fjalëve të fjalorit.

Ata/ato bëjnë prezantimin e punës së tyre. Diskutojnë dhe bëjnë komente rreth veprimeve të secilit prej fëmijëve që ata kanë ngjyrosur, si dhe pasojat që lidhen nga këto veprime. Ftohen të sjellin shembuj nga veprimtaritë e tyre në jetën e përditshme, duke i krahasuar me veprimet e fëmijëve në vizatim.

**Veprimtaria 2**. Nxënësit/et vërejnë figurën e parë dhe lihen të lirë të mendojnë rreth shkakut të vyshkjes së lules. Më pas vizatojnë në kutinë e dytë zgjidhjen e problemit të lules. Prezantohet puna dhe ftohen nxënësit/et të japin shembuj të ngjashëm, duke u bazuar në pervojat personale.

### PËRMBYLLJE

Lexohet rubrika **" Unë"**

**Veprim- Pasojë:**

Unë marr përgjegjësitë e mia.
↓
Unë përmbush të drejtat e mia.
↓
Unë marr mirënjohjen e familjes sime.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e librit dhe lexohen fjalët. Përgjegjësitë në këtë moshë janë të kufizuara, megjithatë mësuesi/ja duhet t'u ndajë përgjegjësi, mundësisht, të gjithë nxënësve/eve të klasës, ashtu siç ndodh me djalin dhe qenin në shtëpi.

Fëmijët kanë përgjegjësi, edhe për njerëzit në familjen e tyre, edhe në komunitet.

Diskutohet për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut. Nxënësit/et tregojnë histori nga jeta e tyre, të ngjashme me këto veprime, dhe tregojnë edhe për vlerësimet që kanë marrë.

Lexohen fjalët: e drejtë, përgjegjësi. Nxënësit/et shpjegojnë kuptimin e këtyre fjalëve duke u bazuar në fotot e dhëna në libër. Mësuesi/ja jep shembuj të përgjegjësive dhe të të drejtave, si për shembull:

| | |
|---|---|
| Kam të drejtë të them atë që mendoj. | Është përgjegjësia ime t'i ndihmoj të tjerët/at. |
| Kam të drejtë për ca kohë qetësi në klasë. | Është përgjegjësia ime të mos zihemi me njëri-tjetrin. |
| Kam të drejtë të luaj sipas regjimit ditor. | Është përgjegjësia ime të dëgjoj atë që thonë të tjerët/at. |

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë orës për:
- qëndrimet të tyre në një situatë;
- për punën në veprimtarinë 1 dhe 2.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre në zgjidhjen e situatave.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2:
- prezantimet;
- komentet dhe vlerësimin për njëri-tjetrin.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Bazuar në sjelljen gjatë jetës së përditshme, nxënësit/et gjejnë shembuj që pasqyrojnë marrjen e përgjegjësive në familje ose në komunitet dhe veprime.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 5. Unë kam një ëndërr…

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**
Cilat janë ëndrrat e mia?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**
1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.4 2.6 3.2 3.3 4.2 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj;
- shpreh dëshirat e tij/saj;
- vlerëson mendimet e qëndrimet e veta dhe të të tjerëve.

**Fjalori:**
ëndërr, realizim.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet. | - të drejtat e fëmijëve<br>- mjedisi |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es. | foto, albume |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, shembujt e sjellë nga vetë ata/ato dhe kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancën, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Bisedohet me nxënësit/et rreth interesave të tyre. Ata/ato ftohen të shprehen me shembuj konkretë.

Këshillohen nxënësit/et që të mbyllin sytë për 2-3 minuta dhe të ëndërrojnë për të ardhmen e tyre, duke u dhënë kështu idenë se nuk duhet të merremi me të shkuarën, por me realizimin e ëndrrave për të ardhmen. Dëgjohen disa nxënës/e, të cilët/at dëshirojnë të flasin në karrigen e autorit (një karrige e nxjerrë para klasës).

Shpjegohet fjala "ëndërr" dhe diskutohet rubrika: **Veprim – Pasojë**:

Unë thur ëndrra për të ardhmen. – Unë mësoj të përmbush ëndrrat e mia.

Diskutohen përgjegjësitë që duhen marrë ose mbajtur që të përmbushen ëndrrat.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e librit dhe të disktutojnë për to ose të grupohen sipas fotove të dhëna në libër.

Ndahet klasa në grupe sipas figurave që përgjedhin. Nxënësit/et orientohen të diskutojnë në grup, të shprehin mendimet me njëri/a-tjetrin/ën, përse përzgjodhën atë figurë dhe se si duhet të veprojnë për ta realizuar.

Përfaqësuesit/et e çdo grupi prezantojnë punën dhe nxënësit/et e tjerë/a ftohen të komentojnë dhe të bëjnë pyetje, sqarime dhe komente, duke i konkretizuar edhe me shembuj.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Nxënësit/et në punë të pavarur lexojnë fjalitë e shkruara rreth figurës së zemrës dhe më pas i shkruajnë ato.

Secili nga ne ka një ëndërr dhe ajo mund të realizohet. Le të tregojmë hapat se si mund të realizohet një ëndërr. Në radhë të parë duhet të kemi besim në vetvete që ne mund ta realizojmë atë. Nxënësit/et lexojnë fjalitë: Unë ëndërroj. Unë mësoj. Unë punoj. Unë realizoj ëndrrën time.

Ata/ato shprehin kuptimin e fjalive, shpjegojnë dhe komentojnë me fjalët e tyre, duke i lidhur ato me realizimin e ëndrrave personale.

Bëhet leximi zinxhir i fjalëve të zemrës nga disa nxënës/e dhe më pas të gjithë së bashku në kor të shoqëruar me ritëm.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit mbyllin sytë përsëri për 2-3 minuta. Të gjithë e shkruajnë ose e vizatojnë ëndrrën e tyre në lulen e vizatuar në libër, bëjnë prezantimin e punës së tyre dhe shprehin mendimet për të. Shpjegojnë kuptimin e fjalëve ose të vizatimit që kanë bërë. Diskutojnë dhe bëjnë komente rreth punëve të shokëve/shoqeve të tyre.

### PËRMBYLLJE

Më pas lexohet rubrika "Unë"

**Veprim–Pasojë:**

Unë i ndaj ëndrrat e mia me shokët/shoqet.

↓

Unë punoj të përmbush ëndrrat e mia.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës për:

- bashkëpunimin në grup;
- punët e tyre individuale.

Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2:

- prezantimet;
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësit/et orientohen që të prezantojnë punët e tyre në familje dhe të shkruajnë, me ndihmën e prindërve, përgjegjësitë e familjes për përmbushjen e ëndrrave të tyre.

| Fusha: | Lënda: | Shkalla: | Tematika: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | "Edukim për shoqërinë" | I | Individët, grupet, shoqëria. |

# 6. Familja ka nevojë për mua

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse familja ka nevojë për mua?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.4 3.1 3.2 3.3 3.5 3.6 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon dhe vlerëson nevojën që ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- dallon lidhjet që ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë: njerëzit e familjes etj.;
- dallon dhe vlerëson atë që mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon.

**Fjalori:**

nevojë, përkujdesje, sukses, sende me vlerë.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet, shkenca natyrore. | - të drejtat e fëmijëve,<br>- mjedisi. |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve etj. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, shembuj të sjellë nga vetë ata/ato dhe kushtet e klasës trajtohen çështje që promovojnë tolerancën, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor, gjinor, moshor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ftohen nxënësit/et të vërejnë foton e situatës në libër dhe lexohet teksti. Ata/ato shprehin mendimet e veta rreth veprimit të Elvit, si u ndje gjyshi i Elvit dhe të sjellin shembuj të ngjashëm nga jeta e tyre.

Me ndihmën e fjalorit shpjegohet fjala nevojë, përkujdesje, sukses.

Parashtrohet rubrika **Veprim – Pasojë**:

Familja ka nevojë për mua.

↓

Unë kam nevojë për familjen.

Nxënësit/et ftohen të shpjegojnë me fjalët e tyre kuptimin e fjalëve si dhe të shprehin përgjegjësitë e tyre ndaj familjes.

Mësuesi/ja parashtron para nxënësve pyetjen "Pse familja ka nevojë për mua" dhe fton nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Orientohen nxënësit/et për të vërejtur fotot e tjera të librit. Shprehin mendimet rreth tyre, komentojnë dhe lexojnë fjalitë poshtë figurave, duke u mbështetur dhe në pyetjen kërkimore.

Duke u bazuar në çdo situatë të dhënë në figurë, ftohen nxënësit/et të sjellin shembuj nga jeta në familjen e tyre.

Familja ime ka nevojë për mua si një anëtar/e i/e përgjegjshëm/e që zbaton rregullat e vendosura në të dhe kështu edhe unë kontribuoj në lumturinë e saj. Suksesi im e bën familjen time krenare. Familja ime ka nevojë për përkujdesjen time.

Nxënësit ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth përkujdesjes që ata tregojnë në mbrojtjen e mjedisit të familjes së tyre.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Lexohet teksti i krahasimit të familjes me pemët. Nxënësit/et shpjegojnë kuptimin e fjalëve, duke u bazuar në njohuritë dhe përvojat paraprake rreth pjesëve kryesore të një peme.

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et të shkruajnë emrat e pjesëtarëve/eve të familjes së tyre në pemën e familjes. Orientohen rreth punës që duhet të bëjnë, duke shfrytëzuar dhe të dhënat e pjesëtarëve/eve të një familjeje, të dhëna në libër.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et bëjnë prezantimin dhe shprehin mendimet për punët e tyre dhe të shokëve/shoqeve. Bëjnë pyetje dhe komentetojnë.

**Veprimtaria 2**. Mësuesi/ja shpjegon se çfarë kuptohet me shprehjen "veprime që e kënaqin familjen time". Për këtë, mësuesi/ja diskuton bashkë me nxënësit/et për figurat e dhëna dhe i nxit ata/ato të flasin se si do të ndiheshin prindërit e tyre për këto veprime. Më pas, nxënësit/et gjejnë rrugën dhe fjalën, e cila është gjetur duke u bazuar në njohuritë e marra gjatë diskutimeve të fotove të librit si dhe shembujve të sjellë nga ata vetë. Nxënësit/et orientohen që të ngjyrosin në vizatimin e dhënë rrugën e veprimeve që kënaqin familjen e tyre. Gjejnë fjalën sekrete, që del nëse ata/ato kanë ngjyrosur saktë vizatimin sipas veprimeve dhe e shkruajnë atë në etiketën përkatëse. Më pas bëjnë prezantimin e punës së tyre si dhe komente rreth punëve të shokëve.

### PËRMBYLLJE

Në fund lexohet rubrika **"Unë"**

**Veprim – Pasojë:**

Nxënësit/et tregojnë shembuj nga jeta e tyre duke u bazuar në veprim – pasojën e mësipërme.

Unë jam i suksesshëm në shkollë.
↓
Unë e bëj familjen krenare.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës për:

- punët e tyre individuale dhe prezantimet.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1&2:

- prezantimet; komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

### DETYRË SHTËPIE

Punë e diferencuar për ata nxënës/e që hasin vështirësi në shkrimin e emrave të pemës së familjes.

Nxënësit/et orientohen që pemën e familjes mund ta pasurojnë dhe me foto sipas pjesëtarëve të familjes.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 7. Unë kam nevojë për të tjerët

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Përse kam nevojë për të tjerët?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.5 2.6 3.1 3.3 3.6 4.2 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon dhe vlerëson nevojën që ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- dallon dhe vlerëson çfarë mund t'u japë të tjerëve/ave dhe mjedisit që e rrethon;
- dallon lidhjet që ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë, të tillë si: shokët/shoqet (në shkollë e jashtë saj); sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme etj.

**Fjalori:**

bashkëpunim, nevojë për të tjerët/at.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet. | - të drejtat e fëmijëve,<br>- mjedisi. |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve etj. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në fotot e tekstit, diskutimet e nxënësve/eve, shembujt e sjellë nga vetë ata/ato dhe kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancën, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të njerëzve në nevojë, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ora e mësimit fillon me leximin e situatës: "Milingona dhe kokrra e grurit". Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth zgjidhjes së problemit nga milingona.

Me ndihmën e fjalorit shpjegohet fjala bashkëpunim dhe më pas diskutohet rubrika: **Veprim – Pasojë**:

Milingona bashkëpunoi me shoqet. – Kokrra iu bë pendë.

Ftohen nxënësit/et të tregojnë shembuj nga jeta e tyre kur kanë patur nevojë për bashkëpunimin me të tjerët/at. Si kanë vepruar kur dikush u ka kërkuar ndihmë ose kur vetë ata kanë kërkuar ndihmë. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë komente për veprimet e njëri-tjetrit.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"


Ndaj me shokët jo vetëm ushqimin.

Lapsat e mi
Janë të mitë, ju mund të merrni disa.
Me ju, do të doja të ndaja gjithçka.
Nëse i ndaj ata me ju,
ju do të keni disa gjithashtu.

Kur bashkëpunojmë, ne kujdesemi për njëri-tjetrin.

Ngjyros vizatimin e fëmijëve që bashkëpunojnë.

Ngjyros vizatimin që tregon kujdes për të tjerët.

Unë
i ndihmoj njerëzit në nevojë.
fitoj mirënjohjen e të tjerëve.

19

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Nxënësit/et vërejnë fotot e librit. Duke u bazuar në pyetjen kërkimore "Përse kam nevojë unë për të tjerët?" shprehin mendimet e tyre rreth figurave dhe fjalive përkatëse.

Ftohen nxënësit/et të ndajnë me shokët e klasës shembuj nga jeta e tyre, të ngjashëm me ato të fotove. Tregojnë se si janë ndier kur kanë ndarë diçka me të tjerët. Lexohet vjersha "Lapsat e mi".

Nxënësit/et komentojnë me fjalët e tyre kuptimin e fjalëve. Sjellin shembuj kur janë kujdesur për të tjerët dhe tregojnë për vlerësimin që kanë marrë prej tyre.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Nxënësit/et vërejnë vizatimet. Duke u bazuar në njohuritë e tyre, në punë të pavarur, dallojnë dhe ngjyrosin vizatimin e fëmijëve që bashkëpunojnë.

Nxënësit/et bëjnë prezantimin e punës së tyre dhe komentojnë veprimet e fëmijëve në vizatimet që kanë ngjyrosur. Vlerësojnë shkaqet e një situate të mundshme konfliktuale midis moshatarëve/eve, duke u bazuar në komentet e vizatimeve 1 dhe 3. Parashtrojnë zgjidhjet e mundshme, duke u bazuar në njohuritë e tyre dhe përvojat paraprake.

**Veprimtaria 2**. Ftohen nxënësit/et të vërejnë vizatimet e veprimtarisë 2. Në punë të pavarur, dallojnë dhe ngjyrosin vizatimin që tregon kujdes ndaj të tjerëve/ave. Prezantojnë punën e tyre dhe tregojnë raste të ngjashme me figurën e ngjyrosur (fig. 2). Bëjnë komente rreth situatave që paraqiten në vizatimet që ata/ato nuk ngjyrosin (fig. 1 dhe 3). Tregojnë shembuj të ngjashëm nga jeta e tyre, me situatat e paraqitura në vizatimin që ata nuk ngjyrosin dhe tregojnë se si kanë vepruar në raste të tilla.

### PËRMBYLLJE

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, në fund të veprimtarive lexohet dhe theksohet shprehja: Luajmë, mësojmë dhe kemi nevojë për njëri/a-tjetrin/ën.

Më pas lexohet rubrika **"**Unë"

Veprim – Pasojë:

Unë i ndihmoj njerëzit në nevojë.
↓
Unë fitoj mirënjohjen e të tjerëve/ave.

Diskutohet me nxënësit/et se kush janë njerëzit në nevojë dhe ftohen të tregojnë nga përvojat e tyre se si janë ndjerë dhe çfarë vlerësimi kanë marrë kur i kanë ndihmuar ata.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës:
- gjatë komenteve dhe diskutimeve;
- për punët e tyre individuale.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës.*
Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2:
- prezantimet;
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

Paraqitja e një situate me anë të vizatimit ku nxënësi/ja bashkëpunon me të tjerët/at.

Mësimi përmendësh i vjershës "Lapsat e mi".

| **Fusha:** Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:** "Edukim për shoqërinë" | **Shkalla:** I | **Tematika:** Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 8. Nevojat dhe dëshirat

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia për të qenë i/e lumtur dhe i/e shëndetshëm/me?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.4 2.5 2.6 3.1 3.3 3.5 3.6

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- shpreh nevojat dhe dëshirat e tij/saj;
- dallon nevojat dhe dëshirat e të tjerëve/ave, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë.

**Fjalori:**

nevojë, dëshirë.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet. | - të drejtat e fëmijëve,<br>- mjedisi |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, shembujt e sjellë nga vetë ata/ato dhe kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancën, respektimin e të drejtës së fëmijëve, të diversitetit kulturor, gjinor, moshor etj. Trajtohen problemet e fëmijëve në vështirësi dhe diskutohet se ç'ndihmesë mund të jepet për ta.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ftohen nxënësit/et të vërejnë foton e situatës në libër dhe të tregojnë rreth nevojave dhe dëshirave të tyre për ditën e parë të shkollës. Gjatë prezantimit të punës së nxënësve/eve, shpjegohen fjalët: nevojë e dëshirë dhe parashtrohet pyetja: "Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia për të qenë i/e lumtur dhe i/e shëndetshëm/me?"

Shkruhen në dërrasë nga mësuesi/ja, në dy grupe, nevojat dhe dëshirat e dala nga diskutimet me nxënësit/et.

Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth plotësimit të nevojave dhe dëshirave të tyre nga familja.

Lexohet dhe diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë.

Unë i di nevojat e mia.

↓

Familja më ndihmon t'i plotësoj ato.

## VEPRIMTARI “TË NXËNËT DUKE BËRË”




### MJEDISI “MËSOJ DUKE KËRKUAR”

**Veprimtaria 1.** Duke u bazuar në vizatimet e dhëna, nxënësit/et do të dallojnë dhe ngjyrosin sendet për të cilat kanë nevojë.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et bëjnë prezantimin dhe shprehin mendimet e veta për punët e tyre dhe të të tjerëve

**Veprimtaria 2**. Orientohen nxënësit/et të vërejnë objektet e dhëna. Në punë të pavarur vizatojnë dëshirat e tyre duke u bazuar në figurat e tekstit ose në njohuritë e tyre.

Pas përfundimit, nxënësit/et prezantojnë punët e tyre. Tregojnë arsyet pse kjo dëshirë duhet që t'u plotësohet dhe sa e realizueshme është ajo.

Nxënësit/et bëjnë komente rreth dëshirave të shokëve/shoqeve dhe dallojnë ato që janë të përbashkëta mes tyre.

### PËRMBYLLJE

Në fund lexohet rubrika “Unë”

Veprim – Pasojë:

Tregojnë shembuj nga jeta e tyre se pse të gjitha dëshirat nuk mund të plotësohen.

Unë kam shumë dëshira.

↓

Unë nuk kërkoj që të gjitha dëshirat të më plotësohen.

### MJEDISI “SHIKO DHE LEXO”

MJEDISI “SHIKO DHE LEXO”

Orientohen nxënësit/et të vërejnë fotot e tjera të librit. Theksohet që nevojat janë kërkesa të domosdoshme për të jetuar, ndërsa dëshirat janë kërkesa jo të nevojshme për të jetuar. Nxënësit shprehin mendimet rreth figurave dhe nevojave të dhëna në libër.

Ata/ato ftohen të tregojnë rreth plotësimit të nevojave të tyre duke i konkretizuar edhe me shembuj. Shembujt i sjellin nga jeta ose duke u bazuar në foto të ndryshme për situatën ku fëmijëve nuk u plotësohen nevojat e domosdoshme për jetesë. Nxënësit ftohen të japin mendimet e tyre rreth zgjidhjes së këtyre problemeve.

Diskutohet me nxënësit se cilat janë nevojat e përbashkëta për të gjithë fëmijët.

Më pas nxënësit/et shprehin disa nga dëshirat që u janë realizuar nga familja e tyre dhe disa të tjera që nuk u janë realizuar. Ata/ato komentojnë arsyet e mosplotësimit të dëshirave dhe diskutojnë rreth mënyrës së sjelljes në këto raste.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a- tjetrin/ën gjatë orës:

- për qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë diskutimit;
- për punët e tyre individuale dhe prezantimet.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, për komentet dhe për mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1dhe 2:

- prezantimet;
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Prezantimi para prindërve të dëshirës së tyre me anë të vizatimit ose me shkrim dhe rendtitja e arsyeve se përse kjo dëshirë duhet t'u plotësohet.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 9. Veprimtari: Luaj me trenin e ëndrrave.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia për të qenë i/e lumtur dhe i/e shëndetshëm/me?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.3

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja

- shpreh nevojat dhe dëshirat e tij/saj;
- dallon nevojat dhe dëshirat e të tjerëve/ave, të përbashkëtat dhe të ndryshmet.
- jep një shpjegim për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij/saj dhe të tjerëve/ave etj.

**Fjalori:**
nevojë, dëshirë.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte, shkenca natyrore. | - të drejtat e fëmijëve,<br>- mjedisi. |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit/es, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. | fletët ngjitëse |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve/eve, në shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et dhe në kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancën, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të njerëzve në nevojë dhe shprehen mendime se si duhet vepruar në raste të tilla etj.

**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Kjo orë fillon me diskutimin e detyrës së shtëpisë. Komentohen dëshirat dhe arsyet e plotësimit të tyre, të cilat nxënësit/et ua kanë prezantuar prindërve të tyre. Renditen dëshirat në dërrasë. Në diskutim me nxënësit, renditen në dërrasë dhe nevojat që ka njeriu për të jetuar.

Gjatë diskutimit nxënësit/et dallojnë nevojat dhe dëshirat e të tjerëve/ave, të përbashkëtat dhe të ndryshmet. Ftohen të sjellin shembuj nga jeta, për fëmijë që nuk i kanë nevojat e jetesës të plotësuara. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre se si duhet të zgjidhet ky problem.

Pas diskutimit, orientohen në zhvillimin e lojës: "Treni i ëndrrave".

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"

Lexoj etiketat. Gjej në fund të librit figurën përkatëse.
Ngjit figurat në tren sipas dëshirave dhe nevojave të mia.

| | | |
|---|---|---|
| Veshje | Biçikletë | Shtëpi |
| Celular | Ajër i pastër | Ujë i pijshëm |
| Qen | Familje | Kompjuter |
| Libër | Ushqim | Shkollim |

23

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Pasi janë shpjeguar rregullat e lojës, nxënësit/et punojnë në punë të pavarur, individualisht.

**Veprimtaria 1.** Lexojnë etiketat. Gjejnë në fund të librit figurat përkatëse.

Ato i ngjitin në tren në vagonët përkatës, sipas dëshirave dhe nevojave të tyre.

Më pas, nxënësit/et bëjnë prezantimin e punës së tyre para klasës.

Nxënësit/et e tjerë/a bëjnë komente, parashtrojnë pyetje në lidhje me nevojat dhe dëshirat e vendosura në vagonë dhe vlerësojnë punët e njëri/a-tjetrit/ës.

Diskutohet me nxënësit/et se cilat nga nevojat që kanë vendosur, janë të nevojshme për ta ose tregojnë shembuj nga jeta reale.

Pas diskutimit të nevojave, ftohen nxënësit/et të shprehin dëshirat e tyre në lidhje me etiketat e vendosura në vagon.

**Veprimtaria 2.** Shkruhen në tabelë fjalët e fletës së dytë nga mësuesi/ja.

Shumë të rëndësishme, Të rëndësishme, Më pak të rëndësishme

Duke përdorur nëntë nevoja, të shkruara në tabelë nga mësuesi/ja, nxënësit/et formojnë "gurin e diamantit".

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | | | shumë e rëndësishme |
| 2 | | 2 | |
| 3 | 3 | 3 | e rëndësishme |
| | 4 | 4 | |
| 5 | | | më pak e rëndësishme |

### PËRMBYLLJE

Në fund bëhet një përmbledhje, duke u bazuar në pyetjen kërkimore "Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia për të qenë i/e lumtur dhe i/e shëndetshëm/me?"

Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre, duke u bazuar në gurin e diamantit.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Orientohen nxënësit/et për të vrojtuar foton e trenit në libër. Shpjegohet, që në tren disa vagonë i kanë rrotat të kuqe dhe disa i kanë jeshile, në lidhje përkatësisht me dëshirat dhe nevojat. Ftohen nxënësit/et të lexojnë etiketat dhe të shpjegojnë me fjalët e tyre kuptimin e tyre. Gjatë shpjegimit të tyre, nxënësit/et përcaktojnë se çfarë përcakton etiketa, si p.sh:

ujë i pijshëm – nevojë;

shkollim – nevojë;

biçikletë – dëshirë, nevojë;

patina – dëshirë etj.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/e vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës:

- për punët e tyre individuale dhe prezantimet.

Vlerësohen nga mësuesi/ja, gjatë orës, me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës*:

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në plotësimin e veprimtarisë "Treni i ëndrrave", për:

- prezantimet;
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

### DETYRË SHTËPIE

Prezantimin e "Trenit të ëndrrave" para prindërve të tyre. Plotësimin e trenit të ëndrrave dhe me figura të tjera sipas dëshirave të tyre.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 10. Fotoreporteri/ja

**Situata e të nxënit**
**Pyetja kërkimore:**
Çfarë mësoj unë nga të tjerët?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**
1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.4 3.1 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 6.1 6.2 7.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- vendos veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe e sheh veten si pjesë të tij;
- shpreh përgjegjësinë e tij/saj ndaj të tjerëve/ave dhe mjedisit;
- ndan me të tjerët/at përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.

**Fjalori:**
fotoreporter/e, zonjë, zotëri.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet | - mjedisi,<br>- bashkjetesa paqësore. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | aparat fotografik, foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në vëzhgimet, në shembujt e sjellë nga vetë nxënësit dhe në kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, gjinor, moshor, respektimin e të drejtës së fjalës së secilit, të njerëzve në nevojë dhe shprehen mendime se si duhet vepruar në raste të tilla etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth fjalës fotoreporter/e. Duke u bazuar në mendimet e nxënësve/eve, shpjegohet puna që bën një fotoreporter/e, mjetet që përdor dhe çfarë mësojnë të tjerët/at nga puna e një fotoreporteri/eje. Prezantohet tema e mësimit "Unë jam fotoreporter/e". Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre se çfarë do të kishin dëshirë të ndanin me të tjerët/at, nëse ata do të ishin në rolin e fotoreporterit/es. Orientohen diskutimet e nxënësve/eve për të përcaktuar ambientet ku do të donin ata/ato të zhvillonin veprimtarinë e tyre si fotoreporter/e.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Pasi nxënësit/et janë pajisur me mjetet përkatëse dhe në varësi të kushteve të klasës, zhvillojnë veprimtari në ambientet brenda dhe jashtë shkollës nën kujdesjen e mësuesit/es. Puna mund të zhvillohet në grup, në punë dyshe ose individualisht. Nxënësit/et sipas dëshirës mund t'i bëjnë pyetje shokëve/shoqeve të klasës, të shkollës, punonjësve/eve të shkollës, por dhe personave jashtë ambienteve të shkollës, për përgjegjësitë që kanë në marrëdhënie me të tjerët/at.

Nxënësit/et të ndihmuar/a dhe nga mësuesi/ja, bëjnë foto dhe mbajnë shënime për personat e intervistuar.

Më pas, nxënësit/et diskutojnë punët e kryera dhe shprehin mendimet e tyre se çfarë mësuan nga të tjerët/at. Të ndihmuar dhe nga mësuesi/ja, përmbledhin fjalitë dhe i shkruajnë në libër. Në varësi të kushteve të klasës, nxënësit/et përgatitin postera me punët e kryera dhe i prezantojnë para klasës.

### PËRMBYLLJE

Në fund, bëhet përmbledhje e punës së kryer dhe diskutohet rubrika: **Veprim – Pasojë.**

Punimet e nxënësve/eve futen në dosjet e tyre personale.

Unë pyes dhe vëzhgoj të tjerët.

↓

Unë mësoj përgjegjësitë e mia.
Unë marr përgjegjësi.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Për të treguar më mirë punën e fotoreporterit/es, nxënësit/et orientohen të vërejnë fotot në libër. Lexohen fjalitë poshtë fotove. Shpjegohen fjalët zotëri, zonjë dhe format e shkurtuara të tyre. Ftohen nxënësit/et të komentojnë përmbajtjen e çdo fotoje dhe të ndajnë me shokët/shoqet e klasës shembuj të ngjashëm me veprimet që paraqiten në foto.

Nxënësve/eve u shpjegohet puna që do të kryejnë praktikisht vetë, duke qenë fotoreporter/e.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës për:
- qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë.
- prezantimin e punës së tyre.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës për:
- llojet e pyetjeve që parashtrojnë;
- qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët/at.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi/ja në punët individuale, në punën dyshe apo në grup për:
- fotot,
- produktin e shkruar,
- prezantimet.
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

Vazhdimin e punës së fotoreporterit/es me persona në lagjen e tyre. Paraqitjen e punës me foto dhe me shkrim në poster.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
| --- | --- | --- | --- |

# 11. Çfarë është respekti?

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si tregojmë respekt?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.4 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.2 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- respekton veten dhe shpreh qëndrimin e tij/saj në marrëdhënie me të tjerët.
- respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.
- beson te vetja dhe te të tjerët.

**Fjalori:**
respekt, fjalë magjike.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
| --- | --- |
| gjuhët dhe komunikimi, artet. | - të drejtat e fëmijëve,<br>- mjedisi,<br>- bashkëjetesa paqësore. |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
| --- | --- |
| teksti i nxënësit, video me situata ku tregohet respekti. | foto, albume, kompjuter, video projektor. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Nxënësit/et marrin pjesë në aktivitete që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, gjinor, moshor etj. gjatë zhvillimit të veprimtarive.

Trajtohen çështje të fëmijëve rom, egjiptianë dhe respektimin e të drejtave të fjalës së njëri/a- tjetrit/ës.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Lexohet situata nga mësuesja/si dhe ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth veprimit të Jonës dhe librares. Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë.

*Jona nuk përdori fjalët magjike,*
*Librarja nuk i shërbeu.*

Zhvillohen situata me role në punë dyshe, në të cilat nxënësit/et përdorin fjalët magjike. Situatat përzgjidhen nga vetë nxënësit/et. Pas prezantimit të punës me role, sipas dëshirës së tyre, nxënësit/et komentojnë veprimet e shokëve.

Mësuesi/ja shfaq në video situata ku tregohet respekt ose mungesë respekti dhe fton nxënësit/et të bëjnë komente rreth tyre.

Shpjegohet fjala "respekt" që do të thotë nderimi që kemi për dikë, duke u nisur nga mosha, nga meritat ose nga cilësitë e tij; qëndrimi me nderim kundrejt diçkaje të shtrenjtë a me vlerë. Mësuesi/ja pyet se si e tregojmë respektin? Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes kërkimore.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1**. Nxënësit/et në punë të pavarur ngjyrosin vizatimin e fëmijëve që tregojnë respekt për veten. Pas përfundimit të punës, ftohen nxënësit/et të bëjnë prezantimin e punës së tyre dhe të krahasojnë veprimet e tyre me veprimet e fëmijëve, të dhëna me vizatim.

**Veprimtaria 2**. Në punë të pavarur, nxënësit/et shënojnë me V fëmijët që tregojnë respekt për të tjerët. Prezantojnë punët e tyre dhe tregojnë me fjalët e veta për figurat të cilat kanë shënuar me V. Ftohen të tregojnë se si do të ndjeheshin po të ishin në vendin e vajzës që qan. Tregojnë shembuj të ngjashëm me këtë situatë nga jeta e tyre.

**Veprimtaria 3**. Nxënësit/et ushtrohen në punë të pavarur për të plotësuar situatën me fjalët magjike që përdoren nga Blerina dhe shitësja. Mësuesja/si pyet njëherë nxënësit/et se si do të vepronin ata në një situatë të tillë dhe më pas nxënësve u tregohet që fjalët magjike i gjejnë në kutinë e fjalëve. Mësuesi/ja në varësi të nivelit të nxënësve u shpjegon nxënësve se fjalët magjike janë me ngjyra sipas dialogut përkatës.

Pasi nxënësit/et shkruajnë fjalët magjike, prezantojnë punët e tyre në punë dyshe me role. Nxënësit/et e tjerë bëjnë komente dhe vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën.

### PËRMBYLLJE

Në fund diskutohet rubrika: Veprim - Pasojë.

Unë respektoj të tjerët.
↓
Unë respektoj veten.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë dhe të shprehin mendimet e tyre rreth kuptimit të fotos së fëmijëve të kapur dorë për dore, në formë rrethi.

Lexohen fjalitë: Respekt për veten. Diskutohet me nxënësit/et se si e tregojnë respektin për veten, duke sjellë shembuj konkretë nga jeta e tyre. Në të njëjtën mënyrë sillen shembuj edhe për rastin respekt për të tjerët, për nga mosha, nga meritat ose nga cilësitë e tij/saj, qëndrim me nderim kundrejt diçkaje të shtrenjtë a me vlerë etj.

Zhvillohet me nxënësit/et loja "Forca e rrethit". Ngrihen para klasës pesë nxënës të kapur dorë për dorë në formë rrethi dhe një nxënës/e që dëshiron të futet brenda rrethit. Nxënësit/et e tjerë vëzhgojnë veprimet që bën nxënësi/ja jashtë rrethit për t'u futur brenda në rreth. Përsëritet kjo veprimtari me një nxënës që është pjesë e rrethit. Nxënësit/et shprehin mendimet se si u ndjenë jashtë rrethit dhe si u ndjenë kur nuk pranoheshin në rreth. Diskutohen me nxënësit/et se si veprojnë në jetën e përditshme kur dikush dëshiron të luajë me ta, si dhe kur nuk dëshirojnë që ai/ajo të luajë me ta.

Orientohen nxënësit/et të vrojtojnë foton në mes të rrethit të fëmijëve ku paraqitet planeti Tokë. Lexohet fjalia: "Respekt për mjedisin". Ftohen nxënësit/et të japin shembuj nga jeta se si tregojnë respekt për mjedisin.

Më pas lexohet nga mësuesi/ja fjalia: "Respekto të tjerët në të njëjtën mënyrë që do të dëshiroje të të respektonin edhe ty". Ftohen nxënësit të komentojnë me fjalët e tyre kuptimin e fjalisë.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues.*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:
- qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë
- prezantimin e punës së tyre.

Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:
- qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët.

*Vlerësim përmbledhës.*

Vlerësohen nga mësuesi për:
- punët individuale dhe në punë dyshe në veprimtaritë 1-3;
- prezantimet individuale dhe ato në punë dyshe e në grup;
- produktin e shkruar në veprimtarinë 3;
- komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrin.

### DETYRË SHTËPIE

Shprehja me anë të vizatimit ose me foto e një situate ku tregohet respekt ndaj të tjerëve.

| **Fusha:** Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:** “Edukim për shoqërinë” | **Shkalla:** I | **Tematika**: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 12. Rolet e mia në familje

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse janë të rëndësishme rolet e mia në familje?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 2.1 2.4 3.3 3.6 4.3 6.2 7.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në familje.
- bashkëvepron me të tjerët në familje për të zgjidhur probleme të ndryshme.
- vlerëson rolin e tij dhe të të tjerëve në familje.

**Fjalori:**

role, familja, përkujdesje, internet, mirënjohje

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| Gjuhët dhe komunikimi, teknologjia dhe TIK-u. | - Mjedisi, bashkëjetesa paqësore |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit, | foto, albume familjare, kompjuter. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në vëzhgimet dhe shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et, kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, gjinor, moshor, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës dhe shprehen mendime se si duhet të veprojnë në raste të tilla.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*


Mësimi 2

Rolet e mia në familje

Unë ndihmoj gjyshen të komunikojë me hallën nëpërmjet Internetit. Gjyshja më falënderon.

Pse janë të rëndësishme rolet e mia në familje?

Çdo fëmijë ka role në familje.
Rolet në familje janë: bir, bijë, vëlla, motër, nip, mbesë.

Fjalor
role
Internet

Për prindërit, jam bija e tyre.

Për vëllanë, jam motra e madhe.

Veprimi dhe pasoja

Unë e ndihmoj gjyshen.

Unë marr falënderimin e gjyshes.

Për gjyshen, jam mbesa e vogël.

Më pëlqen me gjyshen të shëtis ngadalë
e gjërat t'i shohim si në përrallë,
pikat e vesës në lulen e bukur,
ca guralecë e më tutje një flutur.

Sa mirë që të kam, o e ëmbla gjyshe!
Me ty pranë bota duket ndryshe,
qielli më i kaltër, dielli më i ngrohtë
“Sa shumë të dua!” gjithçka sikur më thotë.

30

**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Ora e mësimit fillon me një bisedë rreth komunikimit. Si një proces i rëndësishëm, ai realizohet edhe me anë të kompjuterave/internetit, përdorimit të tij nga ana e fëmijëve dhe të rriturve. Më pas ftohen nxënësit/et të vërejnë foton e librit ku paraqitet një gjyshe dhe një djalë pranë kompjuterit. Lexohet situata dhe ftohen nxënësit/et të japin mendime për veprimin e djalit.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë.

Unë ndihmoj gjyshen.

↓

Unë marr falënderimin e gjyshes.

Nxënësit/et japin shembuj të tjerë nga jeta e tyre, ku tregohet ndihmesa e tyre për pjesëtarët e familjes. Mësuesi/ja shpjegon se *rol* është: vendi që zë diçka në një veprimtari, në një punë, në një organizëm etj., funksion, punë; puna ose detyra që bën ose që merr përsipër dikush përkohësisht në vend të një tjetri. Gjatë kësaj veprimtarie mësuesi/ja shkruan në dërrasë rolet e pjesëtarëve të familjes që dalin nga diskutimet me nxënësit/et. P.sh: vëlla, motër, gjyshe, gjysh, baba, nënë etj.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1**. Ftohen nxënësit/et të luajnë me shokët/shoqet e bankës rolet e tyre në familje. Situatat dhe veprimet përzgjidhen nga nxënësit/et në bashkëpunim me njëri/a-tjetrin/ën. Kjo veprimtari zhvillohet në formën e konkursit, ku nxënësit/et aktrojnë para klasës rolet e përzgjedhura. Pas prezantimit të roleve, nxënësit/et marrin komente dhe vlerësime nga shokët dhe shoqet e klasës.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit/et lexojnë rolet që luajnë në familje dhe qarkojnë rolin që luajnë më mirë në familjen e tyre. Theksohet që, në dialogët e tyre nxënësit/et të përdorin sa më shumë fjalë magjike. Prezantojnë punët e tyre dhe tregojnë arsyen pse mendojnë se e kryejnë më mirë këtë rol. Nxënësit/et mund të qarkojnë dhe disa role. Ftohen nxënësit/et të bëjnë komente dhe vlerësime për njëri-tjetrin.

### PËRMBYLLJE

Në fund, bëhet përmbledhja e punës së kryer dhe diskutohet rubrika: Veprim - Pasojë.

Unë luaj shumë role në familje.

↓

Unë e bëj familjen time të lumtur.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Mësuesi/ja në diskutim me nxënësit/et u shpjegon atyre rolet që ka secili fëmijë në familje, si: bir, bijë, vëlla, motër, nip, mbesë.

Për të konkretizuar këto role, ftohen nxënësit/et të vrojtojnë fotot në libër. Diskutohen rolet dhe veprimet që duhen kryer për të përmbushur këtë rol sa më mirë. Ftohen nxënësit/et të tregojnë shembuj nga jeta e tyre në marrëdhënie me prindërit, motrat, vëllezërit, tezet, hallat, dajat, xhaxhallarët. Nxënësit/et mund t'i konkretizojnë ato dhe me foto personale. Ndaluni dhe fokusojini nxënësit te çështjet si:

- Cilin nga rolet luani më me vështirësi?
- Cilin nga rolet luani më me lehtësi?
- Cilin nga rolet nuk e luani fare?
- Çfarë rolesh të tjerë do të donit të luanit?

Organizoni klasën në aq grupe, sa pyetje janë shtruar për diskutim.

Më pas, mësuesi/ja lexon vjershën e gjyshes dhe fton nxënësit/et të komentojnë me fjalët e tyre, kuptimin e vargjeve të saj. Nxënësit/et sjellin shembuj të ngjashëm në marrëdhëniet me gjyshërit.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë orës për:
- qëndrimet dhe komentet e këtyre gjatë diskutimeve;
- prezantimin e punës.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës për:
- qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale dhe ato me shokun e bankës për:
- prezantimet e punës
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Me ndihmën e prindërve nxënësit/et mësojnë vjershën e gjyshes përmendësh.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: “Edukim për shoqërinë” | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 13. Rolet e mia në klasë

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse janë të rëndësishme rolet e mia në klasë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 3.1 3.2 3.4 3.5 3.6 4.3 5.1 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në klasë.
- vlerëson rolin e tij dhe të të tjerëve në klasë.
- bashkëvepron me të tjerët në klasë për të zgjidhur probleme të ndryshme.

**Fjalori:**

role në klasë, kujdestar, garoj.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet | - mjedisi, bashkëjetesa paqësore, të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, Dispozita Normative 2013, rregullorja e brendshme e shkollës, rregullorja e brendshme e klasës. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj., gjatë punës në grup.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Ora e mësimit fillon me leximin e situatës: “Dëshirat e Rinës në klasën e parë”. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth dëshirave të Rinës që dëshironte të bëhej kujdestare klase, rreshti, e luleve, e mungesave, e cila donte të kryente të gjitha rolet në klasë dhe zgjedhjes që i bënë shokët e shoqet e klasës. Kjo zgjedhje është realizuar në klasë me votim të fshehtë.

Shpjegohen fjalët “role në klasë” dhe veprimtaritë, detyrat dhe përgjegjësitë që ka për çdo rol.

Diskutohet me nxënësit/et rubrika: Veprim – Pasojë: Rina dëshiron shumë role. Ajo e luan mirë rolin si kujdestare e luleve.

Ftohen nxënësit/et të tregojnë rolet që kanë në klasën e tyre, si dhe veprimtaritë që ata kryejnë.

Shkruhen nga mësuesi/ja emrat e roleve që kanë nxënësit/et në klasë.

Parashtrohet pyetja: “Pse janë të rëndësishme rolet e mia në klasë?”. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre, të cilat përmblidhen nga mësuesi/ja p.sh.: për të bashkëpunuar më mirë me njëri/a – tjetrin/ën, për të respektuar njëri-tjetrin etj.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë foton dhe me ndihmën e mësueses/it lexohen emrat e roleve të paraqitura në tekst. Nxënësit/et komentojnë figurat dhe shprehin mendimet e tyre, se kur rolet janë të përmbushura. Me ndihmën e mësueses/it plotësojnë me shkrim fjalinë në tekst.

Shpjegohet nga mësuesi/ja fjala "grup", duke lexuar dhe fjalitë në libër:

**G**arojmë së bashku (duhet të bashkëveprojmë së bashku sepse vetëm kështu mund të fitojmë).

**R**espektojmë njëri/a-tjetrin/ën (nuk flasim shumë dhe dëgjojmë deri në fund pa e ndërprerë shokun).

**U**lim zërin gjatë punës (mësuesja/si stimulon grupet që të flasin me zë të ulët).

**P**unojmë së bashku (vetëm duke punuar së bashku fitojmë). Shembuj:

Shpjegohen rolet e pjesëtarëve të grupit: drejtuesi, shënuesi, mbajtësi i kohës, prezantuesi. Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe katërshe. Drejtuesi i grupit zgjidhet me votë dhe secilit nxënës/e drejtuesi i grupit i jep një rol dhe ndan detyrat e përgjegjësitë në grup. Tema për të cilën do të diskutojnë është: "Karakteristikat e drejtuesit të grupit". Realizohen disa prezantime të punës në grup me dëshirë.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Duke u bazuar në njohuritë e marra për rolet në grup, në këtë veprimtari nxënësit/et në punë individuale lexojnë rolet e shënuara në tabelë dhe më pas dallojnë e ngjyrosin fëmijët në figurë sipas roleve. Nxënësit/et bëjnë prezantimin e punës së tyre. Komentojnë veprimet e fëmijëve te vizatimet që kanë ngjyrosur.

**Veprimtaria 2**. Lexohet kërkesa e veprimtarisë 2. Nxënësit/et shkruajnë rolet që kanë në klasë ose ato role që dëshirojnë të kenë. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et prezantojnë punët, tregojnë se si e kanë përmbushur këtë rol. Nxënësit/et e tjerë japin mendimet e tyre rreth përmbushjes së rolit nga shokët.

Nxënësit/et që kanë shprehur dëshirat për të marrë një rol në klasë, parashtrojnë mendimet e tyre se pse e dëshirojnë këtë rol.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika:

Veprim – Pasojë.

Ftohen nxënësit/et të sjellin dhe shembuj vlerësimi nga nxënësit/et e klasës për rolet e tyre.

Unë luaj disa role në klasë.

↓

Unë jam i vlerësuar nga shokët/shoqet për rolet e mia në klasë.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë orës për:
- punët e tyre individuale dhe në grup,
- përmbushjen e roleve.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit në marrëdhënie me të tjerët.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët në grup dhe ato individuale në veprimtaritë 1dhe 2:
- prezantimet,
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës,
- për përmushjen e roleve të tyre.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Duke u bazuar në kushtet e klasës, nxënësit/et zgjedhin vetë një detyrë për punë në grup.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: “Edukim për shoqërinë” | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 14. Grupet në shkollë

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse grupet janë të rëndësishme?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.3 2.4 3.1 3.3 3.5

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në grup.
- bashkëvepron me të tjerët në grup për të zgjidhur probleme të ndryshme.
- vlerëson rolin e tij/saj dhe të të tjerëve në grup.

**Fjalori:**

grup, anëtar, interesa, mbështetje, shkel rregullat.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet | - mjedisi, bashkëjetesa paqësore |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ. | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në fotot e tekstit, diskutimet e nxënësve, shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et, kushtet e klasës trajtohen çështje të nxënësve romë, egjiptianë, që promovojnë tolerancë, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor, gjinor, moshor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Ora e mësimit fillon me një bisedë me nxënësit/et rreth ushtrimit në sporte të ndryshme. Biseda fokusohet te skuadrat e futbollit që ata pëlqejnë. Më pas, lexohet situata: “Rregullat e lojës së futbollit”. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth veprimeve që mund të ketë bërë Olti që nuk luan dy ndeshje. Në diskutim me nxënësit/et, nxirren disa nga rregullat e lojës së futbollit.

Diskutohet me nxënësit rubrika: Veprim - Pasojë:

Olti ka shkelur rregullat e lojës. → Ai ndëshkohet.

Shpjegohet fjala “ndëshkim”: masë dënimi që merret kundër dikujt për një faj, dënim. Gjithashtu edhe fjala “grup”: tërësi njerëzish që kanë pikëpamje, ide, qëllime e interesa të përbashkëta ose profesion të njëjtë; tërësi njerëzish të organizuar së bashku, që kryejnë të njëjtën punë a veprimtari. Ftohen nxënësit/et të japin raste kur përdoret kjo fjalë gjatë punës në grup.

Parashtrohet pyetja kërkimore: “Pse grupet janë të rëndësishme?”

Gjatë diskutimit me nxënësit/et shpjegohen fjalët e fjalorit: anëtar grupi, interesa, duke i konkretizuar edhe me shembuj konkretë.

Nga mësuesi/ja theksohet që një grup formohet nga njerëz që kanë interesa të përbashkëta. Shpjegohet fjala *interesa*: diçka që më tërheq vëmendjen, më ngjall interes, më pëlqen, më tërheq.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vrojtojnë figurat në tekst dhe të tregojnë rreth grupeve ku bëjnë pjesë ose që kanë dëshirë të marrin pjesë. Duke u bazuar në dëshirat për grupet që pëlqejnë nxënësit, mësuesi/ja ndan klasën në grupe. Nxënësit/et sipas grupeve përkatëse, ndajnë rolet në grup, diskutojnë me njëri/a–tjetrin/ën rreth interesave të tyre, veprimtarive që zhvillon grupi ku bëjnë pjesë, mjetet që përdorin, detyrave, përgjegjësive, vlerësimeve që u janë dhënë në këto grupe.

Nxënësit/et prezantojnë grupin që ata përfaqësojnë para klasës. Nxënësit/et e tjerë bëjnë komente, parashtrojnë pyetje për të mësuar më shumë për grupet e njëri/a- tjetrit/ës.

Pas përfundimit të prezantimit të çdo grupi, mësuesi/ja thekson se anëtarët e grupit ndajnë me njëri/a-tjetrin/ën atë që dinë dhe mund të bëjnë së bashku. Kjo konkretizohet dhe me shembuj nga nxënësit/et e klasës.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Nxënësit/et vrojtojnë figurat e dhëna në veprimtarinë 1. Me ndihmën e mësuesit/es lexohet kërkesa dhe nxënësit/et punojnë individualisht për të gjetur se në cilin grup janë anëtarësuar bashkëmoshatarët. Në fund nxënësit/et shkruajnë grupin ku bëjnë pjesë ose ku kanë dëshirë të jenë anëtarë. Në figurën përkatëse mund ta shprehin atë dhe me vizatim.

Prezantohet puna nga nxënësit/et. Bëjnë komente rreth grupeve që pëlqejnë bashkëmoshatarët e tyre. Nxënësit/et e tjerë bëjnë pyetje dhe komente rreth grupeve të njëri/a- tjetrit/ës.

**Veprimtaria 2**. Ftohen nxënësit/et të vrojtojnë foton e fëmijëve në grup. Diskutohen tiparet e tyre fizike dhe ftohen nxënësit/et të tregojnë rreth pyetjes kërkimore: "Pse grupet janë të rëndësishme?". Lexohen nga mësuesi/ja ose nxënës/e fjalitë:

Grupet na ndihmojnë të mësojmë.

Grupet na bëjnë të ndihemi të vlerësuar.

### PËRMBYLLJE

Në fund, ftohen nxënësit/et të shprehin vlerësimet për grupet e tyre dhe diskutohet rubrika " Unë".

Veprim-Pasojë:

Unë jam anëtar në disa grupe.
↓
Unë ndihem krenar për grupin tim.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a tjetrin/ën gjatë orës për:

- për punët e tyre në grup dhe individualisht.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit gjatë punës në grup.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale në veprimtaritë 1 dhe 2:

- bashkëpunim e punës në grup;
- prezantimet e punës në grup dhe individualisht;
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësit/et ftohen të bëjnë një poster ose punime në grupet ku bëjnë pjesë, duke u bazuar në veprimtaritë e tyre.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: “Edukim për shoqërinë” | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 15. Shoku dhe shoqja ime

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të zë një shok ose një shoqe?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 3.1 3.2 3.3 3.4 3.6 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri.
- vlerëson rolin e tij dhe të të tjerëve në shoqëri.
- bashkëvepron me të tjerët në shoqëri për të zgjidhur probleme të ndryshme.

**Fjalori:**

shok, shoqe, bashkëveproj, besnik.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, artet | bashkëjetesa paqësore |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, foto, albume, KDF, | pazëlla |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në fotot e tekstit, diskutimet e nxënësve, shembuj e sjellë nga vetë nxënësit/et dhe kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a- tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*

Mësimi 5

**Shoku dhe shoqja ime**

Si të zë një shok ose një shoqe?

Fjalor: shok, shoqe, bashkëveproj, besnik

Veprimi dhe pasoja: Rezarti dhe Lira janë shokë të ngushtë. → Ata kalojnë shumë kohë së bashku.

Rezarti dhe Lira janë shokë banke.



Çdo fëmijë ka nevojë për shokë dhe shoqe.



“Unë kam shumë shokë e shoqe, por Danën e kam shoqe të ngushtë.”



“Kur jam i mërzitur, më pëlqen të kaloj kohën me Gjergjin.”



“Era, Taulanti dhe Ardi janë shokët e mi të rinj. Fundjavat i kalojmë së bashku në fshat.”



“Unë dua të rri me Jetën. Kompjuteri na ka forcuar shoqërinë.”

36

Kur bashkëveprojmë i bëjmë detyrat më shpejt, më lehtë dhe më mirë.

**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Mësuesi/ja lexon fjalinë e situatës së dy shokëve të bankës. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth fotos dhe veprimeve të dy fëmijëve. Tregojnë me fjalët e tyre se çfarë mund të ketë ndodhur midis dy shokëve, të cilët i kanë kthyer kurrizin njëri-tjetrit. Theksohet ideja se të gjithë në klasë jemi shokë e shoqe, pavarësisht se jemi apo jo në të njëjtën bankë. Çdo fëmijë ka të drejtën të rrijë me kë të dojë dhe të zgjedhë me cilin/ën shokë ose shoqe dëshiron të rrijë, Megjithëse të ndryshëm, ne kemi shumë gjëra të përbashkëta.

Gjatë diskutimeve të nxënësve, shpjegohen dhe fjalët e fjalorit shok/shoqe: njëri me të cilin jemi lidhur me miqësi gjatë jetës, në një punë a në një veprimtari të përbashkët ose për një çështje të përbashkët; njëri me të cilin kemi pikëpamje, mendime e interesa të përbashkëta, kemi moshë pak a shumë të afërt dhe shkojmë mirë me njëri/a-tjetrin/ën. Shok/qe i/e mirë (i/e vërtetë, i/e rrallë). Janë shokë/qe të ngushtë/ta (të pandarë/ra), shok/qe fëmijërie (vegjëlie), shok/qe shkolle (klase, banke), shok i zemrës etj.

Diskutohet me nxënësit/et rubrika: Veprim – Pasojë:

Rezarti dhe Lira janë shokë të ngushtë. Ata kalojnë shumë kohë së bashku.

Nxënësit/et tregojnë për shokët ose shoqet e tyre dhe mësuesja /si bën një konkurs, se cili/cila ka më shumë shokë e shoqe në klasë.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Mësuesi/ja shtron para nxënësve pyetje të tilla, si:
A ndiheni mirë me shokun/shoqen tuaj?
Çfarë mendoni se mund ta kërcënojë e prishë miqësinë tuaj?
Ç'mendoni se duhet të bëni për të fituar miqësinë e dikujt?
Cilin shpallni shok/shoqe të ngushtë?
Çfarë ndihme do t'i ofronit shokut/shoqes së ngushtë në një rast të caktuar?
Në cilin rast do të prishnit miqësinë me shoku/shoqen tuaj të ngushtë?
Cilat janë disa forma për të uruar shokun/shoqen e ngushtë në një rast suksesi, ditëlindjeje?
Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e tekstit. Me ndihmën e mësuesit/es lexojnë fjalitë, bëjnë komente dhe tregojnë rreth interesave të përbashkëta që kanë me shokët ose shoqet e tyre, si dhe bashkëveprimit që bëjnë me njëri/a-tjetrit/ën për kryerjen e punëve etj.
Gjatë diskutimeve, mësuesi/ja thekson se kur bashkëveprojmë me shokët ose shoqet punët bëhen më mirë dhe ne ndihemi më mirë.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et të vrojtojnë "Murin e miqësisë". Më ndihmën e mësuesit/es lexohet kërkesa. Mësuesja/si thekson se nuk është e vështirë të zësh një shok/shoqe. Ftohen nxënësit/et të shprehin idetë e tyre dhe më pas lexohen dhe shpjegohen fjalitë. Shpjegohet fjala "besnik": një njeri që e mban deri në fund zotimin ose që nuk i shmanget asnjëherë detyrës së marrë përsipër; që ndjek pa u lëkundur një tjetër, me të cilin është lidhur nga një ideal a nga një qëllim i përbashkët; që nuk tradhton; që nuk i ndryshon ndjenjat dhe qëndrimin kundrejt dikujt a diçkaje, që e ruan deri në fund dashurinë për të ose që e ndjek dhe e mbron atë deri në fund. Ftohen nxënësit/et të sjellin shembuj për konkretizimin e kësaj fjale. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për plotësimin me pazëlla (gjenden në fund të librit) "Murin e miqësisë". Nxënësit/et prezantojnë punët e tyre dhe shprehin mendimet e tyre rreth pazëllave që ata vendosën në mur.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim – Pasojë

Nxënësit/et sjellin edhe shembuj konkretë nga jeta e tyre në shoqëri, për kënaqësinë që kanë marrë ose kanë dhënë.

Unë kam shumë shokë dhe shoqe.
↓
Unë marr dhe jap kënaqësi.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë orës për:

- qëndrimet gajtë komenteve dhe diskutimeve,
- për plotësimin e "Murit të miqësisë."

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës, me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- prezantimin e punës së "Murit të miqësisë",
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

- Një vizatim për shokun ose shoqen e tyre ku të shprehin mirënjohje për ta.
- Një përshkrim ose disa vargje për shokun ose shoqen e tyre.

| Fusha:<br>Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:<br>“Edukim për shoqërinë” | Shkalla:<br>I | Tematika:<br>Individët, grupet, shoqëria. |
|---|---|---|---|

# 16. Unë jam vullnetar

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të ndihmoj njerëzit në vështirësi?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.3 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- pranon që ka njerëz që kanë vështirësi për të kuptuar dhe për të bërë gjëra të ndryshme.
- tregon gatishmërinë për t’i ndihmuar njerëzit në vështirësi.
- bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme.

**Fjalori:**

vullnetar, njerëz në vështirësi, mirënjohje.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi | bashkëjetesa paqësore. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ. | foto, albume, |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respekt për njerëzit në vështirësi, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/ra-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*


Mësimi 6

Unë jam vullnetar

Si të ndihmoj njerëzit në vështirësi?

Ina dhe shokët e saj të klasës përgatitën kartolina për njerëzit në vështirësi. Ata morën mirënjohjen e tyre.

Vullnetarë janë njerëzit **që** kryejnë me dëshirë dhe pa pagesë veprimtari të ndryshme.

Fjalor
vullnetar
vështirësi
mirënjohje

Veprimi dhe pasoja

Klasa e Inës përgatiti kartolina.

Ata morën mirënjohje nga njerëzit në vështirësi.

Kryqi i Kuq Shqiptar

38

**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Mësuesi/ja lexon fjalinë e situatës së dy shokëve të bankës. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth fotove. Shpjegohen fjalët e fjalorit “njerëz në vështirësi”. Nxënësit/et sjellin shembuj konkret për njerëzit në vështirësi. Gjithashtu, gjatë diskutimeve me nxënësit/et, mësuesi/ja shpjegon kuptimin e fjalës “mirënjohje”, që do të thotë ndienja që ushqejmë për dikë, i cili/e cila na ka ndihmuar ose na ka bërë të mira.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë:

Klasa e Inës përgatiti kartolina.

↓

Ata/ato morën mirënjohje nga njerëzit në vështirësi.

Nxënësit/et tregojnë raste konkrete nga jeta e tyre, për ndihmën që kanë dhënë ata/ato vetë ose njerëz të tjerë për njerëzit në vështirësi.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Ftohen nxënësit/et të vrojtojnë në figurat e tekstit. Orientohen nxënësit/et rreth punës që do të kryejnë për plotësimin e çdo figure me fjalitë përkatëse. Më ndihmën e mësuesit/es lexohet kërkesa dhe fjalitë poshtë tyre. Për t'u ardhur në ndihmë nxënësve me vështirësi në të nxënë, mësuesi/ja i orienton për gjetjen e fjalive, duke u bazuar në ngjyrat e shkrimit dhe të paragrafëve. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur. Më pas, prezantojnë punët dhe bëjnë vlerësimin e njëri/a- tjetrit/ës.

**Veprimtaria 2**. Duke u bazuar në punën në grupe, si dhe në punën e kryer individualisht, si dhe në kushtet e klasës dhe mjedisit ku jetojnë nxënësit/et, mësuesi/ja fton nxënësit/et që të shprehin mendimet e tyre rreth ndihmës konkrete që kanë dëshirë të japin për njerëzit në vështirësi.

Diskutohen idetë dhe mendimet e nxënësve dhe hartohen së bashku me nxënësit/et, plane vullnetare për të ndihmuar njerëzit në vështirësi.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive, diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë

Unë ndihmoj vullnetarisht njerëzit në vështirësi.

↓

Unë marr mirënjohjen e tyre.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Parashtrohet pyetja kërkimore: "Si të ndihmoj njerëzit në vështirësi?" Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes. Me ndihmën e mësuesit/es lexohen fjalitë në tekst. Shpjegohet fjala "vullnetarë" dhe veprimtaritë që vullnetarët kryejnë. Për të konkretizuar më mirë këtë, ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot e tekstit.

Mësuesi/ja u flet nxënësve për "Kryqin të Kuq" dhe veprimtarinë e Kryqit të Kuq shqiptar. Diskutohet me nxënësit/et për nevojat që mund të kenë njerëzit në vështirësi. Nxënësit/et ndahen në grupe. Çdo grup diskuton për njerëzit në vështirësi që njohin dhe ndihmës konkrete që mendojnë se mund të japin. Nxënësit/et prezantojnë punët e tyre në grup, diskutojnë dhe bëjnë komente rreth punëve të njëri/a-tjetrit/ës.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:

- qëndrimet gjatë komenteve dhe diskutimeve,
- plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës, me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- punën në grup,
- prezantimin e punës në veprimtarinë 1,
- komentet dhe vlerësimin e njëri/ra-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësime përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

- përgatitja e kartolinave për njerëzit në vështirësi,
- mbledhja e ndihmave sipas dëshirës së tyre për njerëzit në vështirësi.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria |
|---|---|---|---|

# 17. Unë dhe i panjohuri

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të sillem me një të panjohur?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.
- bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme.

**Fjalori:**

i panjohur, numri i policisë 129.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte. | - të drejtat e fëmijëve |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit, | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë: të drejtat e fëmijëve, diversitetin kulturor, moshor, tolerancën etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Kjo orë mund të fillojë me një bisedë me nxënësit/et rreth kuptimit të fjalës "njeri i panjohur", që nënkupton dikë që nuk e njohim, që nuk e dimë kush a çfarë është, si është. Më pas, mësuesi/ja lexon fjalitë e situatës. Nxënësi/ja shpreh mendimet e tij/saj, se si ka vepruar Eli.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë:

I panjohuri e ftoi Elin në makinë.

↓

Ajo vrapoi për te miku më i mirë.

Ftohen nxënësit/et të tregojnë se si do të vepronin ose raste të ngjashme si kanë vepruar me njerëzit e panjohur.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Me ndihmën e mësuesit/es lexohet kërkesa e veprimtarisë 1. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth situatës dhe më pas, në punë të pavarur, të gjejnë rrugën e fëmijëve për në vendet e sigurta. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit/et prezantojnë dhe komentojnë rreth vendeve të sigurta që fëmijët kanë gjetur. Diskutohet me nxënësit/et si do të kishin vepruar ata në rast se do t'u kishte ndodhur një ngjarje e tillë.

**Veprimtaria 2**. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në punë dyshe. Nxënësit/et plotësojnë me shkrim përgjigjen e djalit. Më pas, në lojë me role, prezantojnë punët e tyre para klasës. Nxënësit/et e tjerë bëjnë komente dhe vlerësimin për punët e njëri/a- tjetrit/ës.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim – Pasojë

Unë nuk komunikoj me njerëz të panjohur.

↓

Unë di si të sillem me të panjohurit.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Parashtrohet pyetja kërkimore: "Si të sillem me një të panjohur?". Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes. Më pas, diskutojnë rreth përmbajtjes së figurave dhe me ndihmën e mësuesit/es, lexohen fjalitë në tekst. Nxënësit/et bëjnë komente rreth situatave që paraqitura në figura dhe ftohen të tregojnë raste konkrete nga përvojat e tyre. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve rreth rolit të policisë, në ndihmë të njerëzve. U paraqet nxënësve numrin e policisë 129 dhe i fton të tregojnë se çfarë veprimesh duhet të bëjnë për të njoftuar policinë.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë orës për:

- qëndrimet gjatë komenteve dhe diskutimeve;
- plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1 dhe 2.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës, me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- prezantimin e punës në veprimtarinë 1 dhe 2,
- bashkëveprimin me njëri/a-tjetrin/ën në punë dyshe,
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie.

Për shembull:

- paraqitja me anë të vizatimit ose me shkrim, të veprimeve se si duhet të sillemi me të panjohurin.

| Fusha:<br>Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:<br>“Edukim për shoqërinë” | Shkalla:<br>I | Tematika:<br>Individët, grupet, shoqëria |
|---|---|---|---|

# 18. Unë dhe mjedisi

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si mund të mbrojmë mjedisin?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë.
- bashkëvepron me të tjerët në grup për të zgjidhur probleme të ndryshme.

**Fjalori:**

mjedis, mbetje, siguri, riciklim.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte | - mjedisi |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | foto, albume, objekte me materiale të riciklueshme. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë të drejtat e fëmijëve, respektimit të mendimit të njëri/a- tjetrit/ës, tolerancë etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Ora e mësimit mund të fillojë nga mësuesi/ja me një bisedë rreth mjedisit të klasës, të shkollës, të lagjes ku banojnë e jetojnë nxënësit/et. Shpjegohet fjala “mjedis”: tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, zhvillohet një dukuri etj.; gjithçka që rrethon një organizëm dhe ndikon mbi të; hapësira a sendet që na rrethojnë. Më pas, fton nxënësit/et të vërejnë foton e tekstit dhe lexohen fjalitë e situatës. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth veprimit të Dorit, i cili i hedh mbeturinat në koshat përkatës. Tregojnë me fjalët e tyre pse mbeturinat duhen hedhur sipas koshave përkatës. Mësuesi/ja shpjegon fjalën “riciklim”: procesi në të cilin materialet e destinuara për eliminim, mund të grumbullohen, ripërpunohen, riprodhohen dhe përdoren sërish si lëndë e parë.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë:

Dori hedh mbeturinat në koshat përkatës.

↓

Ai jeton në mjedis të pastër.

Parashtrohet pyetja kërkimore: “Si të mbroj mjedisin?”. Nxënësit/et sjellin përvojat e tyre jetësore, se si veprojnë me mbeturinat dhe si kujdesen për mbrojtjen e mjedisit.

## VEPRIMTARI “TË NXËNËT DUKE BËRË”




### MJEDISI “MËSOJ DUKE KËRKUAR”

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa dhe ftohen nxënësit/et të vërejnë figurat e tekstit. Nxënësit/et diskutojnë në punë dyshe rrugën që bëjnë mbetjet. Më pas, ndajnë mendimet e tyre me nxënësit/et e tjerë të klasës. Ftohen të sjellin dhe shembuj të tjerë ushqimesh që i konsumojnë.

**Veprimtaria 2**. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për të lidhur me shigjetë mbeturinat me koshin përkatës. Pasojat e këtij veprimi janë: zvogëlon nevojën për hapësira të landfilli-it, kursen taksat, kursen harxhimin dhe energjinë me 2/3, zvogëlon ndotjen, mbron burimet tona të pamjaftueshme, e bën botën një vend të këndshëm për të jetuar. Nxënësit/et prezantojnë punët, bëjnë komente dhe sjellin shembuj të tjerë mbeturinash që hidhen sipas koshave përkatës. Diskutohet më nxënësit/et shprehja “Bëhu superhero, shpëto Tokën”. Mësuesi/ja paraqet para nxënësve objekte të krijuara p.sh. me letër, kënaçe etj. dhe nxënësit/et shprehin mendime rreth riciklimit.

**Veprimtaria 3.** Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth problemit që ka vajza dhe mjedisi ku kërkon të luajë. Diskutohen pasojat që vijnë nga prerja e pemëve dhe në punë me grup ftohen të japin një mesazh për gjithë njerëzit e komunitetit.

Unë nuk i hedh mbetjet në koshat e caktuar.

↓

Unë nuk ndihmoj në riciklimin e mbetjeve mjedisore.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive, diskutohet dhe rubrika: Veprim – Pasojë

### MJEDISI “SHIKO DHE LEXO”

Me ndihmën e mësuesit/es lexohen fjalitë në tekst. Shpjegohet kuptimi i fjalës “mbetje”: janë lëndët, objektet ose pjesët e tyre, të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t’i largojë (që përcaktohen nga autoriteti përgjegjës). Mbetjet vlerësohen si të tilla, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet në procesin e prodhimit. Gjithashtu, theksohet ndryshimi midis mbeturinave: materialet që mbeten pas përpunimit, djegies termike, kompostimit ose riciklimit. Mbeturinat në përgjithësi eliminohen në vendgroposje. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre për çdo situatë, të paraqitura në figura, duke i konkretizuar me ngjarje nga jeta e tyre dhe tregojnë pasojat që ndodhin nëse veprojnë kundër shprehjeve të paraqitura në tekst.

Lexohen fjalët: *Toka jonë, planeti ynë, përgjegjësia jonë* dhe ftohen nxënësit/et të shprehin mendime rreth tyre. Duke u bazuar në figurat e librit, diskutohet me nxënësit/et rreth planetit Tokë si dhe çfarë përfaqësojnë ngjyrat e paraqitura në të. Mësuesja/si shpjegon fjalën “planet” që është një trup qiellor, që rrotullohet rreth Diellit dhe merr prej tij dritën dhe ngrohtësinë.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën gjatë orës për:
- gjatë komenteve dhe diskutimeve,
- për veprimet e tyre në mbrojtje të mjedisit.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:
- prezantimin e punës në veprimtarinë 1- 3.
- bashkëveprimin me njëri-tjetrin në punë dyshe.
- komentet dhe vlerësimin e njëri/ra-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- paraqitja me anë të vizatimit e rrugës që bëjnë mbetjet e një ushqimi që konsumon.
- krijimi i një objekti sipas dëshirës me materiale të riciklueshme.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Individët, grupet, shoqëria |
|---|---|---|---|

# 19. Veprimtari: Mësoj dhe luaj

**Situata e të nxënit**

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**
1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.
- flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku bëjnë pjesë.
- vlerëson rolin e tij dhe të të tjerëve në familje, klasë, grup, lagje etj.

**Fjalori:**
Detyrë kontrolli

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi | mjedisi, bashkëjetesa paqësore, të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ, | zar, petëza me ngjyra. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë zhvillimit të lojës diskutohen me nxënësit/et çështje që promovojnë tolerancë, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a- tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Mësuesi/ja prezanton veprimtarinë para nxënësve. Shpjegohet fjala "detyrë kontrolli": shqyrtimi edhe një herë me kujdes i një pune për të parë në ç'gjendje është, si është kryer puna, si janë zgjidhur çështjet e veçanta, për të vërtetuar nëse është i përpiktë përfundimi i arritur dhe për të nxjerrë përfundime për qëllime të caktuara; rishikimi i vëmendshëm i fakteve, i dokumenteve etj. Jepen udhëzimet e zhvillimit të lojës si më poshtë.

Loja zhvillohet në grupe me nga katër nxënës. Grupet përzgjidhen nga mësuesi/ja duke bërë numërimin 1-4 dhe, sipas numrave, nxënësit/et formojnë grupet. Çdo grup pajiset me një zar dhe katër petëza me ngjyra të ndryshme. Mësuesi/ja, sipas kushteve të klasës, përgatit etiketat e veprimtarisë, të cilat ia shpërndan çdo grupi. Shembujt e etiketave mund të jenë situata për kujdesin ndaj mjedisit, për bashkëjetesën paqësore, të drejtat e fëmijëve etj. Etiketat vendosen në çdo grup, në mes të tavolinës, në pozicionin mbrapsht dhe nxënësit/et do të udhëzohen që t'i përzgjedhin ato në mënyrë të rastësishme. Ftohen nxënësit/et të bëjnë pyetje dhe komente rreth zhvillimit të lojës.

## VEPRIMTARI “TË NXËNËT DUKE BËRË”




### MJEDISI “MËSOJ DUKE LUAJTUR”

Pasi mësuesi/ja ka dhënë udhëzimet e lojës dhe mjetet përkatëse për çdo grup, nxënësit/et zhvillojnë lojën.

Nxënësit/et hedhin me radhë zarin dhe, sipas numrit që i bie, lexojnë kërkesat që shkruhen në etiketat e tekstit dhe kryejnë veprimet. Nxënësit/et vlerësojnë njëri/ra- tjetrin/ën për kryerjen e veprimeve dhe zgjidhjen e situatës problemore të etiketës së detyrës së kontrollit.

Mësuesi/ja vrojton zhvillimin e lojës së nxënësve. Mban shënime për zhvillimin e punës në grup të nxënësve, në fillim të lojës se si nxënësit/et bashkëveprojnë për fillimin e saj, gjatë zhvillimit të lojës dhe në fund të lojës. Gjatë këtij vëzhgimi mësuesi/ja vëzhgon: bashkëpunimin e nxënësve me njëri/a-tjetrin/ën, komunikimin e tyre, kryerjen e veprimeve, zgjidhjen e situatave në etiketat e dhëna, si dhe fjalorin e përdorur gjatë zhvillimit të veprimeve të lojës.

Në varësi të kohës, nxënësit/et mund ta zhvillojnë disa herë lojën. Në fund, nxënësit/et shprehin komentet e tyre rreth lojës, vlerësojnë njëri/ra-tjetrin/ën, nxjerrin fituesit e çdo grupi.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim – Pasojë

Unë bashkëveproj me të tjerët.
↓
Unë mësoj duke luajtur.

### SHEMBUJ ETIKETASH

**1.** Një shoqja ime më kërkon lapsat me ngjyra. Unë:
A. duhet t’ia jap,
B. nuk duhet t’ia jap,
C. nuk duhet t’i kthej përgjigje.
**Përgjigje e saktë**. Kalo një kuti.
**Përgjigje e gabuar.** Kthehu dy kuti.

**2.** Klasa ime ka shkuar ekskursion në park. Mbeturinat:
A. duhet t’i lë në vendin ku luaj,
B. duhet t’i mbledh në vendin ku luaj,
C. duhet t’i hedh në kosh.
**Përgjigje e saktë.** Kalo dy kuti.
**Përgjigje e gabuar.** Kthehu në fillim.

**3.** Një fëmijë me aftësi të kufizuara ka nevojë për ndihmën time. Unë:
A. nuk duhet ta ndihmoj,
B. duhet të largohem nga ai,
C. duhet ta ndihmoj.
**Përgjigjia e saktë.** Kalo një kuti.
**Përgjigje e gabuar.** Kthehu në fillim
**4. ...** etj.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë lojës për:
- zgjidhjen e situatave të etiketave të detyrës së kontrollit,
- kryerjen e veprimeve sipas kërkesave të lojës.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, bashkëpunimin dhe kryerjen e veprimtarive të lojës.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi për:
- zhvillimin e lojës në grup,
- kryerjen e veprimeve sipas kërkesave të lojës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- shprehja me anë të një vizatimi e falënderimit për një shokë ose shoqe të tyre, i cili/e cila i ka ndihmuar.
- kartolina falënderimi për një shok ose një shoqe për ndihmesën që u kanë dhënë.

| Fusha:<br>Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:<br>"Edukim për shoqërinë" | Shkalla:<br>I | Tematika:<br>Individët, grupet, shoqëria |
|---|---|---|---|

# 20. Unë jam fotoreporter

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si bashkëveproj me të tjerët?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2 7.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.
- respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.
- beson te vetja dhe te të tjerët.
- flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku bëjnë pjesë.

**Fjalori:**
Informacion në internet.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| Gjuhët dhe komunikimi. | Mjedisi, të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit etj. | foto, albume, aparat fotografik, kompjuter, videoprojektor. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në vëzhgimet dhe shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et, kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, gjinor, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a- tjetrit/ës, të njerëzve në vështirësi dhe shprehen mendime se si duhet të veprojnë në raste të tilla.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Prezantohet nga mësuesi/ja tema e mësimit "Unë jam fotoreporter" dhe shfaqen në videoprojektor disa situata ku paraqiten fëmijë që bashkëveprojnë për kryerjen e një pune. Ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre rreth përmbajtjes së fotove që prezantohen dhe të shprehin dëshirat e tyre se çfarë do të dëshironin të ndanin me të tjerët, nëse ata/ato do të ishin në rolin e fotoreporterit. Orientohen diskutimet e nxënësve për të përcaktuar mjediset ku do të donin të zhvillonin veprimtarinë e tyre si fotoreporter.

Parashtrohet pyetja kërkimore: "Si bashkëveproj unë me të tjerët?".

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Për të orientuar nxënësit/et për punën që do të bëjnë si fotoreporter, ftohen të vërejnë fotot në libër. Lexohen fjalitë poshtë fotove. Ftohen nxënësit/et të komentojnë përmbajtjen e çdo fotoje dhe të ndajnë me shokët e klasës shembuj të ngjashëm me veprimet që paraqiten në fotografitë e dhëna. Shpjegohen fjalët "informacion" që do të thotë: njoftim që marrim për diçka, të dhëna për gjendjen e punëve në një fushë të caktuar, për veprimtarinë e dikujt, për një ngjarje etj. dhe fjalën "internet".

Mësuesi/ja u shpjegohet nxënësve për punën që do të kryejnë vetë, praktikisht në rolin e fotoreporterit.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Pasi janë pajisur me mjetet përkatëse dhe në varësi të kushteve të klasës, nxënësit/et zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda mjediseve të shkollës nën kujdesin e mësueses/it. Puna mund të zhvillohet në grup, në punë dyshe ose individualisht. Nxënësit/et sipas dëshirës mund t'i bëjnë pyetje shokëve të klasës, por dhe nxënësve të klasave të tjera të shkollës. Mësuesja/si duhet të theksojë rregullat e një interviste, duke improvizuar edhe në klasë situata të tilla.

Nxënësit/et të ndihmuar dhe nga mësuesi/ja bëjnë foto dhe mbajnë shënime për personat e intervistuar.

Më pas, nxënësit/et diskutojnë në klasë punët e kryera dhe shprehin mendimet e tyre se çfarë mësuan nga të tjerët. Të ndihmuar edhe nga mësuesi/ja përmbledhin fjalitë dhe i shkruajnë në libër. Në varësi të kushteve të klasës, nxënësit/et përgatitin dhe postera me punët e kryera dhe i prezantojnë para klasës.

Unë bashkëveproj.

↓

Unë mësoj përgjegjësitë e mia.
Unë mësoj të respektoj të tjerët.
Unë luaj rolet e mia.
Unë marr mirënjohje nga shokët e grupit.

### PËRMBYLLJE

Në fund, bëhet përmbledhja e punës së kryer dhe diskutohet rubrika:

Veprim - Pasojë.

Punimet e nxënësve futen edhe në dosjet e tyre personale.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit vlerësojnë njëri/ra - tjetrin/ën gjatë orës për:
- qëndrimet dhe komentet e tyre gjatë veprimtarisë,
- prezantimin e punës së tyre.

Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:
- llojet e pyetjeve që parashtrojnë,
- qëndrimet e tyre në marrëdhëniet me të tjerët.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale, në punë dyshe apo në grup për:
- fotot,
- produktin e shkruar,
- prezantimet.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- vazhdimi i punës së fotoreporterit me persona të tjerë që kanë dëshirë.
- paraqitja e punës me foto e me shkrim në poster.

| Fusha:<br>Shoqëria dhe mjedisi | Lënda:<br>"Edukim për shoqërinë" | Shkalla:<br>I | Tematika:<br>Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 21. Rregullat e klasës

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse duhet të zbatoj rregullat në klasë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në klasë.
- pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar.
- vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij/saj të përditshme.

**Fjalori:**

rregull, rregulla, rregullore.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte | mjedisi, bashkëjetesa paqësore. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë të drejtat e fëmijëve, respektimin e mendimit të njëri-tjetrit, tolerancën etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ora e mësimit mund të fillojë nga mësuesi/ja, duke u bazuar në një situatë që mund të ketë ndodhur në klasë. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth situatës dhe parashtrojnë argumentet pro ose kundër për të. Diskutohet me nxënësit/et rreth kuptimit të fjalëve:

Rregull – rregulli ka të bëjë me individin, të qenët e çdo gjëje në vendin e vet, aty ku duhet dhe ashtu siç duhet të jetë.

Rregulla – rregullat kanë të bëjnë me shoqërinë dhe përbëhen nga tërësia e rregullave që shërbejnë për të siguruar mbarëvajtjen në shkollë dhe në punë.

Rregullore - dokumenti që përmban rregullat e mbarëvajtjes në shkollë dhe në punë.

Më pas, lexohet situata në tekst. Nxënësit/et komentojnë veprimin e Deas dhe diskutohet rubrika: Veprim–Pasojë.

Dea mori kotelen në klasë. - Ajo theu rregullin.

Mësuesja/si shtron pyetjen se, çfarë do të ndodhte nëse secili nga ne do të merrte një kafshë në shkollë.

Nxënësit/et flasin për raste konkrete nga jeta e tyre, të cilat tregojnë zbatimin ose moszbatimin e rregullave. Mësuesi/ja parashtron pyetjen kërkimore: "Pse duhet të zbatoj rregullat në klasë?"

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"


Qarko fëmijët që kanë thyer rregullat e klasës.

Shkruaj një rregull për nxënësit e kësaj klase.

Unë

i zbatoj rregullat e klasës.

respektohem nga të tjerët.

bëj atë që kërkoj nga të tjerët.

51

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot në tekst dhe të lexojnë fjalitë përkatëse për çdo foto. Diskutohet përmbajtja e secilës prej tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprimet e tyre me ato që paraqiten në foto.

Lexohen rregullat e klasës, të paraqitura në tekst. Ftohen nxënësit/et të sjellin shembuj rreth hartimit dhe zbatimit të tyre në klasë. Shprehin mendimet e tyre për rregullat që dëshirojnë të kenë në klasë. Mësuesi/ja përmbledh rregullat që dalin nga diskutimet me nxënësit/et dhe i shkruan në dërrasë.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Mësuesja/si formon tri grupe fëmijësh, duke numëruar 1, 2, 3. Grupi i "njëshave" do të jetë në rolin e *folësit*, ndërsa dy grupet e tjera, "dyshat" dhe "treshat", do të jenë në rolin e *dëgjuesve*.

Anëtarët e grupit të parë, për rreth 3-4 minuta, do të flasin për një problem që nuk është vetëm i tyre. Tema mund të jetë një grindje me një shok apo një shoqe, kujdesi ndaj mjedisit etj.

Anëtarët e grupit të dytë e të tretë, *dëgjuesit*, do të zgjedhin një fishë me udhëzime të tilla, si: ndërpriteni folësin shpesh, ndërsa është duke folur, bëni pyetje për të sqaruar thelbin e asaj që ai/ajo thotë, ktheni kokën majtas ose djathtas dhe filloni të pëshpëritni me dikë tjetër, ndërkohë që folësi vazhdon të flasë.

Mësuesja/si pyet anëtarët e grupit të folësve se çfarë mendojnë për aftësitë dëgjuese të shokëve të tyre dhe së bashku vendosin disa rregulla të thjeshta.

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për të qarkuar në foton e dhënë në tekst, fëmijët që kanë thyer rregullat e klasës. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et komentojnë veprimet e nxënësve që janë në kundërshtim me rregulloren e klasës.

**Veprimtaria 2.** Duke u bazuar në komentet dhe vlerësimin e tij/saj për veprimet e nxënësve të klasës, të paraqitura në tekst, nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për të shkruar një rregull për nxënësit/et e kësaj klase.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive, diskutohet dhe rubrika: Veprim–Pasojë.

-Nxënësit/et bëjnë komente dhe vlerësim, duke u bazuar në shembujt nga puna e tyre në klasë.

Unë zbatoj rregullat e klasës.
↓
Unë respektohem nga të tjerët.
↓
Unë bëj atë që kërkoj nga të tjerët.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë orës për:

- gjatë komenteve dhe diskutimeve për hartimin e rregullores.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- prezantimin e punës në veprimtarinë 1 dhe 2,
- për zbatimin e rregullores së klasës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

- paraqitja me anë të vizatimit e veprimeve të nxënësve të klasës që kanë thyer rregulloren.
- shkrimi i një rregulli për nxënësit/et e klasës së tyre.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 22. Rregullat në shkollën tonë

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**
Përse duhen rregullat në shkollë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij/saj të përditshme.
- diskuton për rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë etj.

**Fjalori:**
vlerësim

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte | mjedisi, bashkëjetsa paqësore. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë të drejtat e fëmijëve, respektimin e mendimit të njëri-tjetrit, tolerancën etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Mësuesi/ja mund ta fillojë orën e mësimit me një situatë, ku tregohet zbatimi ose moszbatimi i rregullave në shkollën ku jep mësim. Fton nxënësit/et të japin komentet rreth situatës që parashtron mësuesi/ja. Mësuesi/ja shpjegon fjalën "garë" që do të thotë: formë e aktivitetit në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, që ka për qëllim të përhapë përvojën e më të përparuarve, të nxitë forcat e gjalla krijuese e të sjellë rritjen e përgjithshme të rendimentit të punës; të dyja palët përpiqen t'i kryejnë sa më shpejt e sa më mirë, që t'ia kalojnë njëri/a-tjetrit/ës. Më pas, mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë situatën e tekstit. Gjithashtu shpjegohet fjala "vlerësim": jap mendim për dikë a për diçka, përcaktoj rëndësinë, dobinë ose vlerën shoqërore të dikujt a të diçkaje, i jap dikujt atë që meriton, çmoj. Nxënësit/et sjellin shembuj nga jeta e tyre në shkollë për zbatimin e moszbatimin e këtyre rregullave, pasi u është lexuar edhe rregullorja e shkollës. Mësuesja/si thekson domosdoshmërinë për gjithëpërfshirjen në zbatimin e këtyre rregullave. Diskutohet rubrika Veprim - Pasojë.

Unë nuk zbatoj rregullat në klasë.

↓

Klasa ime nuk fiton garën.

Më pas mësuesi/ja parashtron pyetjen kërkimore: "Përse na duhen rregullat në shkollë?"

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur duke shënuar me (V), në foton e dhënë në tekst, fëmijët që kanë ndjekur rregullat e shkollës.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et komentojnë veprimet e nxënësve që janë në kundërshtim me rregulloren e shkollës. Krahasojnë këto veprime me ato që bëjnë nxënësit/et e shkollës së tyre. Nxënësit/et tregojnë me fjalët e tyre se çfarë pasojash sjell moszbatimi i rregullores së shkollës. Ftohen të bëjnë komente dhe vlerësime për punët e njëri/a–tjetrit/ës.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit/et në punë të pavarur shkruajnë një rregull për shkollën e tyre dhe më pas e prezantojnë atë, duke sjellë dhe argumentet përse duhet ajo.

**Veprimtaria 3.** Mësuesja/si fton nxënësit/et të lexojnë tekstin e këngës. Më pas, së bashku me mësuesin/en, këndohet kënga, duke e shoqëruar ritin e saj me përplasje duarsh ose me mjete të tjera rrethanore. Kënga mund të këndohet edhe në grup, duke zhvilluar një konkurs brenda klasës se cili e këndon më mirë.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim–Pasojë.

Unë zbatoj rregullat e shkollës.
↓
Unë vlerësohem nga të gjithë.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Ftohen nxënësit/et të vërejnë fotot në tekst dhe më pas lexohen fjalitë përkatëse për çdo foto. Nxënësit/et krahasojnë veprimet e tyre me ato që paraqiten në foto. Bëjnë komente për veprimet e njëri–tjetrit në zbatim të rregullores së shkollës.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për rregullat që dëshirojnë të kenë në shkollë dhe të japin argumente përse duhen ato. Përmblidhen rregullat që dalin nga diskutimet me nxënësit/et dhe i shkruan në dërrasë. Mësuesja/si drejton diskutimet e nxënësve dhe sjell shembuj nga jeta e tyre për të dalë në konkluzionin se zbatimi i rregullave na ndihmon të bashkëpunojmë dhe të arrijmë gjithmonë suksesin.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a–tjetrin/ën gjatë orës për:

- gjatë komenteve dhe diskutimeve për zbatimin e rregullores së shkollës,
- zbatimin e rregullores së shkollës.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës, me shprehje për qëndrimet dhe komentet e tyre.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- prezantimin e punës në veprimtarinë 1-3,
- komentet dhe vlerësimin e punës së njëri/a-tjetrit/ës,
- për zbatimin e rregullores së shkollës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- paraqitja me anë të vizatimit i veprime të nxënësve që kanë zbatuar ose thyer rregulloren shkollës.
- të mësojnë këngën përmendësh.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 23. Rregullat në komunitet

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Pse komuniteti ka nevojë për rregulla?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- dallon rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në komunitet.
- pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar.
- respekton rregullat në çdo fushë të veprimtarisë.

**Fjalori:**

komunitet, harmoni, i sigurt.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte. | Mjedisi, bashkëjetesa paqësore. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | kompjuter, videoprojektor, foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë të drejtat e fëmijëve, respektimit të mendimit të njëri-tjetrit, tolerancë dhe diversitet kulturor gjinor, moshor në komunitet etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*



Mësimi 3

Rregullat në komunitet

Nertila me motrën e saj luajnë shpesh tenis në mjediset e pallatit. Fqinjët shqetësohen.

Pse komuniteti ka nevojë për rregulla?

Komuniteti është grupi i njerëzve që jetojnë, banojnë e punojnë së bashku.

Fjalor: komunitet, harmoni, i sigurt

Veprimi dhe pasoja: Motrat luajnë në mjediset e pallatit. → Fqinjët shqetësohen nga zhurma.

Rregullat në komunitet na ndihmojnë të jetojmë në harmoni me të tjerët.

Të ecim të sigurt. Të mbajmë pastër mjedisin. Të luajmë të sigurt.

54

**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë e situatës dhe më pas, duke u bazuar në foton përkatëse, shprehin mendimet e tyre rreth veprimeve të Nertilës dhe motrës së saj. Nxënësit/et diskutojnë rreth pasojës që vjen nga loja e fëmijëve në pallat: *fqinjët u shqetësuan nga zhurma.* Mësuesi/ja fton nxënësit/et të krahasojnë veprimet e tyre me ato të motrave dhe të tregojnë shembuj nga jeta e tyre se në çfarë mjedisesh luajnë në kohën e lirë. Gjatë diskutimit me nxënësit/et, shpjegohet fjala "komunitet": grupi i njerëzve që jetojnë, banojnë e punojnë së bashku. Gjatë diskutimeve, nxënësit/et komentojnë veprimet e njëri/a-tjetrit/ës për vendin ku luajnë dhe japin mendimet e tyre rreth pasojave që mund të kenë lojërat kur nuk zhvillohen në vende të caktuara.

Mësuesi/ja parashtron pyetjen kërkimore: "Pse komuniteti ka nevojë për rregulla?"

## VEPRIMTARI “TË NXËNËT DUKE BËRË”




### MJEDISI “SHIKO DHE LEXO”

Nxënësit/et vërejnë foton në tekst ku paraqitet një komunitet dhe shprehin komentet e tyre për të. Dallojnë vendin ku luajnë fëmijët, ku jetojnë, ku pushojnë, ku punojnë njerëzit etj. Krahasojnë mjedisin e paraqitur në foto me mjedisin ku ata jetojnë dhe shprehin mendimet e tyre se çfarë do të donin të kishin të përbashkët dhe ndryshe në mjedisin e tyre. Mësuesi/ja orienton diskutimet e nxënësve rreth përgjigjes së pyetjes kërkimore. Lexohen fjalitë në tekst dhe nxënësit/et tregojnë se përse na nevojiten rregullat në komunitet. Shpjegohen fjalët: “harmoni”–të shkuarit mirë me njëri/a-tjetrin/ën, marrëdhënie miqësore ndërmjet dy ose më shumë vetëve, “i sigurt”–diçka që është jashtë çdo rreziku, që është i mbrojtur mirë. Nxënësit/et, gjatë shpjegimit, bazohen në fotot e dhëna në tekst dhe krahasojnë veprimet e tyre me ato që paraqiten në foto. Bëjnë komente për veprimet e njëri/a–tjetrit/ës në zbatim të rregullave në komunitet.

### MJEDISI “MËSOJ DUKE KËRKUAR”

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa. Nxënësit/et punojnë në grup për të ngjyrosur figurën ku fëmijët luajnë të sigurt.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et komentojnë veprimet e nxënësve që nuk zbatojnë rregullat në komuntet. Krahasojnë këto veprime me ato që kanë vënë re në komunitetin ku jetojnë. Nxënësit/et tregojnë se çfarë pasojash sjell moszbatimi i rregullave në komuntet.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit/et, në punë të pavarur, shënojnë me (V) figurat që tregojnë kujdes ndaj mjedisit. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et diskutojnë për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozojnë masa që duhen ndërmarrë për evidentimin e tyre. Mësuesi/ja mund të shfaqë pamje të mjediseve të ndryshme në videoprojektor dhe nxënësit/et shfaqin mendime rreth tyre.

**Veprimtaria 3.** Nxënësit/et dallojnë fëmijët që nuk zbatojnë rregullat në autobus. Disktutojnë për veprimet e tyre dhe japin mendime se si duhet të sillemi në autobus me njerëz të moshave të ndryshme. Nxënësit/et tregojnë dhe përvojat e tyre personale se si veprojnë kur udhëtojnë me autobus.

Unë zbatoj rregullat në komunitet.
↓
Unë jetoj në harmoni me veten.
↓
Unë jetoj në harmoni me të tjerët.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive, diskutohet dhe rubrika: Veprim–Pasojë.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë orës për:
- gjatë komenteve dhe diskutimeve rreth zbatimit të rregullave në komunitet,
- kryerjen e veprimtarisë 1-3.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre rreth zbatimit të rregullave në komunitet.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:
- kryerjen e punës në veprimtarinë 1-3,
- qëndrimet, komentet dhe vlerësimin e punës së njëri/a-tjetrit/ës,
- për zbatimin e rregullave në komunitetin ku jetojnë.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

- paraqitja me anë të vizatimit ose me shkrim i veprimeve të nxënësve që kanë zbatuar ose thyer rregullat në komunitetet ku jetojnë.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 24. Siguria në rrugë

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të eci i sigurt në rrugë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor.
- identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij në rrugë.

**Fjalori:**

vijat e bardha, semafor, kaskë, rrip sigurimi.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte | mjedisi |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | kompjuter, videoprojektor, foto, albume. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë të drejtat e fëmijëve, respektimin e mendimit të njëri-tjetrit, tolerancës, diversitetin moshor, gjinor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ora e mësimit mund të fillojë nga mësuesi/ja me bisedën rreth rrugës që bëjnë fëmijët për të ardhur në shkollë. Nxënësit/et tregojnë se si veprojnë kur kalojnë rrugën, ku kalojnë etj.

Më pas, nxënësit/et lexojnë situatën në tekst dhe komentojnë veprimet e Adorës dhe Arbrit, duke u mbështetur në figurën përkatëse. Shpjegohet fjala: "vijat e bardha", ku gjenden ato, përse shërbejnë dhe pse njerëzit duhet të kalojnë në vijat e bardha.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë.

Adora dhe Arbri ecin te vijat e bardha. Ata janë të sigurt në rrugë. Mësuesi/ja paraqet dhe situata të tjera në videoprojektor ku njerëzit, gjatë lëvizjes, respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor. Më pas, mësuesja/si orienton kërkimin e nxënësve, duke u bazuar në pyetjen: Si të eci i sigurt në rrugë?

## VEPRIMTARI “TË NXËNËT DUKE BËRË”




### MJEDISI “MËSOJ DUKE KËRKUAR”

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa. Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për të qarkuar në foton e dhënë në tekst njerëzit që zbatojnë rregullat e qarkullimit dhe me të kuqe ata që nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et komentojnë veprimet e njerëzve që nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit rrugor. Tregojnë me fjalët e tyre për pasojat që vijnë nga moszbatimi i rregullave të qarkullimit. Krahasojnë këto veprime me veprimet e tyre, duke i konkretizuar dhe me shembuj nga jeta e tyre.

**Veprimtaria 2.** Mësuesi/ja mund të improvizojë me nxënësit/et, në oborrin e shkollës, një rrugë me semafor, vija të bardha, polic/e ose mund t’i kryejnë këto veprime në një rrugë afër shkollës. Nxënësit/et kryejnë veprime për kalimin e rrugës. Pas veprimeve që një nxënës/e kryen, nxënësit/et e tjerë shprehin komentet e tyre dhe bëjnë vlerësime për njëri-tjetrin.

Unë respektoj shenjat e qarkullimit në rrugë.
↓
Unë lëviz i sigurt.
↓
Unë përmbush përgjegjësitë e mia në komunitet.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim–Pasojë.

### MJEDISI “SHIKO DHE LEXO”

Nxënësit/et lexojnë fjalitë në tekst. Tregojnë rreth shenjave të qarkullimit rrugor dhe përse shërbejnë ato. Diskutojnë dhe shpjegojnë me fjalë veprimet që bëhen nga njerëzit, duke patur parasysh ngjyrat e semaforit. Tregojnë për rolin e policisë në zbatimin e rregullave të qarkullimit. Nxënësit/et tregojnë dhe shembuj nga jeta e tyre rreth respektimit të shenjave të qarkullimit rrugor. Shpjegohet fjala “kaskë”: kapelë mbrojtëse. Ftohen nxënësit/et të tregojnë rreth përdorimit dhe rolit të saj në sigurinë e njerëzve. Nxënësit/et komentojnë figurën ku paraqitet një vajzë me rrip sigurimi në makinë. Nxënësit/et sjellin përvojat e tyre në përdorimin e rripit të sigurimit gjatë udhëtimit me makinë dhe pse është i nevojshëm përdorimi i rripit.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë orës për:

- gjatë komenteve dhe diskutimeve për zbatimin e rregullave të qarkullimit,
- kryerjen e veprimtarive 1 dhe 2.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre dhe komentet e tyre dhe vlerësimin e njëri-tjetrit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- prezantimin e punës në veprimtarinë 1 dhe 2.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie.

Për shembull:

- paraqitja me vizatim e semaforit dhe fjalët përkatëse për çdo ngjyrë me shkrim.
- shkrimi i një rregulli duke u bazuar dhe në figurën e tekstit.

| Fusha: | Lënda: | Shkalla: | Tematika: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | "Edukim për shoqërinë" | I | Pushteti, autoriteti, qeverisja. |

# 25. Higjiena ime

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të mbaj një higjienë të mirë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 5.1 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të higjienës.
- demonstron gatishmërinë e tij/saj për të ndjekur rregullat e higjienës në veprimtaritë e përditshme në familje, klasë, shkollë etj.

**Fjalori:**

higjienë, dezinfektoj.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte. | mjedisi |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ. | foto, albume. mjetet e kutisë së ndihmës së shpejtë. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Ora e mësimit fillon me veprimtarinë "Kontroll i pastërtisë vetjake". Kujdestari i pastërtisë kontrollon pastërtinë e duarve të nxënësve dhe prezanton para klasës gjetjet. Duke u bazuar në këto gjetje, mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë e situatës "Sëmundja e Dorës". Diskutohet rubrika Veprim-Pasojë.

Dora hëngri fruta pa larë duart.

↓

Ajo u sëmur.

Nxënësit/et diskutojnë rreth gjetjeve të kujdestarit të pastërtisë së klasës dhe sjellin shembuj të ndryshëm nga jeta e tyre personale. Mësuesi/ja shpjegon fjalën "higjienë", që do të thotë zbatimi i rregullave praktike që ruajnë shëndetin tonë.

Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth pasojave që vijnë nga mosmbajtja e një higjiene të mirë. Parashtrojnë argumentet e tyre me shembuj konkretë nga përvojat e tyre ose të të tjerëve që njohin.

Duke u bazuar në të dhënat e nxënësve, mësuesja/si parashtron pyetjen: Si të mbaj një higjienë të mirë?

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Lexohet kërkesa e veprimtarisë 1. Nxënësit/et, në punë të pavarur, ngjyrosin rrugën e veprimeve për larjen e duarve. Pas përfundimit të punës, mësuesja/si fton nxënësit/et ta prezantojnë atë para klasës. Prezantimin e punës nxënësit/et mund ta bëjnë dhe konkretisht, duke kryer veprime të improvizuara dhe duke bërë komentin me gojë. Mësuesja/si duhet të theksojë mënyrën e fërkimit të gishtërinjve me njëri-tjetrin për një kohë të gjatë. Pas çdo prezantimi, nxënësit/et e tjerë bëjnë pyetje, komente rreth veprimeve të njëri/a–tjetrit/ës.

**Veprimtaria 2**. Në këtë veprimtari nxënësit/et, në punë të pavarur, shënojnë me (V) kur duhet t'i lajnë fëmijët duart, para dhe pas veprimtarive të tyre të përditshme. Mësuesja/si fton nxënësit/et të shkëmbejnë punët me njëri/a–tjetrin/ën dhe të bëjnë vlerësimet. Nxënësit/et komentojnë dhe vlerësojnë punët e shokëve.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim – Pasojë.

Nxënësit/et ftohen të tregojnë me fjalët e tyre, se si duhet të veprojnë për të pasur një higjienë të mirë.

Unë zbatoj rregullat e higjienës.

↓

Unë jam i shëndetshëm.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Lexohet fjalia: "Jam i shëndetshëm kur.....". Ftohen nxënësit/et të vërejnë figurat e tekstit dhe lexojnë fjalët poshtë tyre. Për çdo figurë, nxënësit/et japin mendimet e tyre se si veprojnë për t'i zbatuar ato gjatë jetës së përditshme. P.sh. sa herë në ditë i lajnë dhëmbët dhe kur? etj. Mësuesi/ja orienton diskutimet e nxënësve për të treguar rreth pasojave që vijnë nga moszbatimi i veprimeve të paraqitura në figurë, p.sh: mbaj dorën përpara kur teshtij, etj.

Në figurën ku paraqitet një fëmijë që mjekon plagën, mësuesja/si shpjegon fjalën "dezinfektim", që do të thotë pastrim i një vendi a një sendi nga mikrobet ose nga lëndët helmuese. Gjithashtu, u tregon konkretisht nxënësve se si bëhet mjekimi i një plage.

Ftohen nxënësit/et individualisht, por dhe në punë dyshe të demonstrojnë para klasës veprimet për mjekimet e një plage. Pas çdo demonstrimi, nxënësit/et e tjerë bëjnë komente dhe vlerësojnë njëri/a-tjetrin/ën.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a– tjetrin/ën gjatë orës për:

- mbajtjen e një higjiene të mirë,
- plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1 dhe 2.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës, me shprehje, përqendrimet e tyre, komentet dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:

- mbajtjen e një higjiene të mirë,
- prezantimin e punës në veprimtarinë 1 dhe 2,
- komentet dhe vlerësimin e njëri/a-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:

- paraqitja me shkrim e veprimeve që bëjnë për të patur një higjienë të mirë.
- shprehja me anë të vizatimit e veprimeve për një higjiene të mirë.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: "Edukim për shoqërinë" | Shkalla: I | Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 26. Të shëndetshëm

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si të kem shëndet të mirë?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**

Nxënësi/ja:

- flet për rëndësinë e respektimit të rregullave për të patur shëndet të mirë.

**Fjalori:**

ushqim, sport.

| **Lidhje me fushat kurrikulare:** | **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi | - të drejtat e fëmijëve. |

| **Burimet e informacionit:** | **Mjetet/materialet mësimore:** |
|---|---|
| teksti i nxënësit, libri IZHA 2012 "për një ushqyerje të shëndetshme", KDF, DUDNJ. | foto, albume, mjete të kuzhinës, si: lugë, pirun, thikë, pecetë etj. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respekt për njerëzit në vështirësi, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a-tjetrit/ës, të diversitetit kulturor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Mësuesi/ja mund ta fillojë mësimin me një bisedë më nxënësit/et rreth ushqimeve të tyre të preferuara. Nxënësit/et shpjegojnë me fjalët e tyre çfarë kuptojnë me fjalën "ushqim". Rendit në dërrasë disa prej ushqimeve që pëlqejnë nxënësit/et. Më pas, mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë dhe të lexojnë situatën e paraqitur në tekst. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth ushqimeve që konsumojnë fëmijët në figurën e tekstit dhe parashtrojnë argumente se cili prej fëmijëve del i pari në garë. Mësuesja/si fton nxënësit/et të flasin për sportet që pëlqejnë dhe ushtrojnë. Nxënësit/et shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë kuptojnë me fjalën "sport". Rendit disa prej sporteve që pëlqejnë nxënësit/et në dërrasë.

Diskutohet rubrika: Veprim–Pasojë.

Unë nuk ushqehem shëndetshëm.

↓

Unë nuk fitoj garën.

Mësuesi/ja parashtron pyetjen kërkimore: "Si të kem shëndet të mirë"? Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Nxënësit/et, në punë të pavarur, ngjyrosin figurat sipas ngjyrave përkatëse të numrave dhe lexojnë rregullat e tavolinës në anë të figurës. Më pas, mësuesja/si fton nxënësit/et të prezantojnë rregullat e tavolinës, duke kryer veprime konkrete në një tavolinë të improvizuar para klasës. Nxënësit e tjerë bëjnë komente dhe vlerësime për njëri-tjetrin.

**Veprimtaria 2.** Nxënësit/et shënojnë me (V) fëmijët që zbatojnë rregullat e tavolinës. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et japin argumentet e tyre, duke u bazuar në figurë, se çfarë gabimesh kanë bërë fëmijët që nuk shënohen me (V).

**Veprimtaria 3.** Nxënësit/et në punë të pavarur shkruajnë ose vizatojnë sportin që ushtrojnë. Prezantojnë punët e tyre dhe vlerësojnë punët e njëri/a-tjetrit/ës.

**Verpimtaria 4.** Në fjalëkryqin e dhënë në tabelë, nxënësit/et qarkojnë emrat e ushqimeve bazike, të dhëna me ngjyra të ndryshme. Më pas, lexojnë fjalët e qarkuara dhe vlerësojnë punën e njëri/a-tjetrit/ës.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika:

Unë ushqehem shëndetshëm. + Unë ushtrohem në sporte.

↓

Unë jam i shëndetshëm.

Veprim – Pasojë.

Ftohen nxënësit/et të tregojnë rreth vendimeve që kanë marrë ose duhet të marrin për të ushqyerit e mirë dhe ushtrimit me sport.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Lexohen fjalitë në tekst dhe nxënësit/et bëjnë komente rreth vakteve ushqimore ditore dhe orarit të tyre. Ftohen të parashtrojnë pyetje për njëri/a-tjetrin/ën dhe të përgjigjen, duke dhënë shembuj konkretë nga ushqimet që konsumojnë sipas vakteve dhe orarit, kur i konsumojnë dhe t'i krahasojnë ato me të dhënat në tekst.

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve mësues/ja thekson rëndësinë e të ushqyerit të mirë dhe ushtrimit të sporteve. Më pas, fton nxënësit/et të vërejnë figurën ku paraqiten llojshmëri ushqimesh dhe sportet. Mësuesja/si orienton diskutimet e nxënësve rreth rëndësisë së konsumimit të frutave dhe të perimeve. Duke u bazuar në preferencat e nxënësve sipas sporteve përkatëse, mësuesi/ja jep shembuj konkretë, p.sh. për futbollistë si, Kristiano Ronaldo, Lionel Mesi etj. Nxënësit/et ftohen të tregojnë rreth sporteve që ushtrojnë dhe dëshirave të tyre.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:
- komentet dhe pyetjet që i drejtojnë njëri/a-tjetrit/ës.
- për plotësimin dhe prezantimin e veprimtarisë 1- 4.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për qëndrimet e tyre, komentet, argumetet e sjella gjatë diskutimeve dhe mënyrën e të shprehurit.

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për:
- prezantimin e punës në veprimtarinë 1-4.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- paraqitja në tabelë me shkrim ose vizatim e ushqimeve që hanë sipas vakteve.
- paraqitja me vizatim e sportit që dëshirojnë të ushtrojnë.

| Fusha: | Lënda: | Shkalla: | Tematika: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | "Edukim për shoqërinë" | I | Pushteti, autoriteti, qeverisja. |

# 27. Rreziqet në shtëpi

**Situata e të nxënit**
**Pyetja kërkimore:**
Pse duhet të jem i kujdesshëm në shtëpi?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.2 5.1 6.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij në shtëpi.
- flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të sjelljes në shtëpi.

**Fjalori:**
rrezik, numrat e urgjencës, detergjent.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi, arte | - të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit, KDF, DUDNJ. | foto, albume, kompjuter, videoprojektor. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Gjatë diskutimeve me nxënësit/et, trajtohen çështje që promovojnë tolerancë, respekt për njerëzit në vështirësi, respektimin e të drejtës së fjalës së njëri/a- tjetrit/ës, të diversitetit kulturor, gjinor, moshor etj.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI "KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT"**

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë temën "Rreziqet në shtëpi" dhe fton nxënësit/et të shpjegojnë me fjalët e tyre kuptimin e fjalës "rrezik". Përmblidhen mendimet e nxënësve, duke shpjeguar që "rrezik" do të thotë një gjendje e vështirë, në të cilën dikujt a diçkaje mund t'i ndodhë një fatkeqësi, mundësia e një të keqeje të menjëhershme që kërcënon dikë a diçka. Nxënësit/et japin shembuj rreziqesh që njohin në shtëpi, japin argumente pro ose kundër gjatë diskutimit me njëri/a-tjetrin/ën.

Diskutohet rubrika: Veprim – Pasojë.

- Unë nuk jam i kujdesshëm.
- Unë nuk jam i sigurt.

Duke u bazuar në diskutimet e nxënësve gjatë rubrikës "Veprim–Pasojë", mësuesi/ja parashtron pyetjen kërkimore: "Pse duhet të jem i kujdesshëm në shtëpi?" Nxënësit/et ftohen të shprehin mendimet e tyre rreth pyetjes.

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

**Veprimtaria 1.** Nxënësit/et të lexojnë kërkesën dhe të vërejnë situatat ku paraqiten veprimet e fëmijëve në shtëpi. Në punë të pavarur, nxënësit/et qarkojnë fëmijët që nuk kryejnë veprime të sigurta në shtëpi. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë rreth çdo veprimi të sigurt dhe të pasigurt që kryejnë fëmijët në situatat e tekstit. Mësuesi/ja fton nxënësit/es të tregojnë rreth pasojave që mund të vijnë nga këto veprime. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bëjnë komente për veprimet që kanë kryer shokët e tyre në shtëpi. Mësuesja/si thekson hapat e veprimeve që duhet të ndjekim në raste të tilla rreziku, si: të ruajmë qetësinë, të njoftojmë më të rriturit dhe të mos veprojmë pa u konsultuar me më të rriturit. Hapi i tretë është që të njoftojmë numrat e urgjencës, të cilët duhet t'i dijë çdo fëmijë.

**Verpimtaria 2** Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë në grupe. Çdo grup do të paraqesë në rol një situatë se si duhet të veprojnë ndaj rreziqeve në shtëpi P.sh.: në shtëpi ka rënë zjarr ose motra e tyre është shumë sëmurë. Pas çdo demostrimi, nxënësit/et e tjerë bëjnë komente, pyetje dhe vlerësime. Tregojnë se cilat janë rreziqet në shtëpi, çfarë pasojash vijnë prej tyre dhe propozojnë alternativa parandalimi dhe zgjidhjeje si duhet të sillen ndaj tyre, duke ndarë përvojat e tyre me të tjerët.




Unë i di rreziqet në shtëpinë time.
↓
Unë di të bëj kujdes.
↓
Unë jam i sigurt.

### PËRMBYLLJE

Në fund të veprimtarive diskutohet dhe rubrika: Veprim–Pasojë.

### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Më pas mësuesi/ja shfaq në videoprojektor disa situata rreziqesh në shtëpi ose u tregon ngjarje të tilla si: rënie zjarri në shtëpi, një pjesëtar i familjes sëmuret në shtëpi etj. Nxënësit/et shprehin mendimet se si duhet vepruar në këto raste. Mësuesja/si orienton nxënësit/et në leximin e udhëzimeve në libër dhe u shpjegon nxënësve se çfarë janë numrat e emergjencës duke u bazuar dhe në figurat përkatëse të tyre.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*
Nxënësit/et vlerësojnë njëri/a – tjetrin/ën gjatë orës për:
- kryerjen dhe prezantimin e veprimtarisë 1 dhe 2.

Vlerësohen nga mësuesi/ja gjatë orës me shprehje për komentet, argumentet e sjella gjatë diskutimeve dhe respektimin e mendimeve të njëri/a- tjetrit/ës.

*Vlerësim përmbledhës:*
Vlerësohen nga mësuesi/ja për:
- prezantimin e punës në veprimtarinë 1 dhe 2,
- komentet dhe vlerësimin e njëri/ra-tjetrit/ës.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- shkrimi i disa rregulla mbrojtëse ndaj rreziqeve në shtëpi.
- paraqitja me anë të vizatimit ose me shkrim i veprime të sigurta në shtëpi.
- shkrimi dhe vendosja në shtëpi e numrave të emergjencës të dhëna në libër.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: “Edukim për shoqërinë” | Shkalla: I | Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja. |
|---|---|---|---|

# 28. Unë jam fotoreporter

**Situata e të nxënit**

**Pyetja kërkimore:**

Si duhet të sillem në mjediset publike?

**Ndihma në rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** 1.1 1.2 1.3 1.4 2.1 2.2 2.3 2.4 2.5 2.6 3.1 3.2 3.3 3.4 3.5 3.6 4.1 4.2 4.3 5.1 6.1 6.2 7.1

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**
Nxënësi/ja:
- identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij/saj në mjedise publike.
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.
- flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të sjelljes në mjedise publike.

**Fjalori:**
mjedis publik, muze, bibliotekë, ekspozitë, kinema, piknik.

| Lidhje me fushat kurrikulare: | Lidhja me temat ndërkurrikulare: |
|---|---|
| gjuhët dhe komunikimi. | mjedisi, të drejtat e fëmijëve. |

| Burimet e informacionit: | Mjetet/materialet mësimore: |
|---|---|
| teksti i nxënësit | foto, albume. aparat fotografik, kompjuter, videoprojektor. |

**TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË**

Duke u bazuar në vëzhgimet dhe shembujt e sjellë nga vetë nxënësit/et, si dhe kushtet e klasës, trajtohen çështje që promovojnë respektimin e të drejtës së fjalës dhe shprehjes së mendimeve, diversitet kulturor, moshor, gjinor, respektit ndaj vetes dhe të tjerëve në mjediset publike.

*Libri i nxënësit Edukim për shoqërinë 1*




**MJEDISI “KOMUNIKIMI DHE TË SHPREHURIT”**

Mësuesi/ja zhvillon bisedë me nxënësit/et për vizitat në muze, ekspozitë, për një piknik që mund të kenë bërë me klasën ose me prindërit etj. Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre rreth kuptimit të këtyre fjalëve si, muze, ekspozitë, piknik etj. të cilat mësuesi/ja i shkruan në dërrasë. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se të gjitha këto mjedise quhen mjedise publike. Ftohen nxënësit/et të tregojnë për veprimtaritë që kanë kryer në këto mjedise. Prezantohet nga mësuesi/ja tema e mësimit “Unë jam fotoreporter” dhe ftohen nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre se çfarë kanë dëshirë të ndajnë me të tjerët për të kryer sa më mirë rolin e fotoreporterit në mjediset publike, si dhe ku dëshirojnë të kryejnë veprimtaritë e tyre. Mësuesi/ja, në varësi të kushteve të klasës, mund ta ketë planifikuar këtë temë më parë, duke marrë mendimet e nxënësve për kryerjen e një vizite në një mjedis publik ose mund ta ketë zhvilluar në formë e një projekti ndërlëndor me lëndët: gjuhë shqipe, arte etj. dhe nxënësit/et, gjatë kësaj ore, zhvillojnë përmbushjen e produkteve të projektit.

Parashtrohet pyetja kërkimore: “Si duhet të sillem në mjediset publike?”

## VEPRIMTARI "TË NXËNËT DUKE BËRË"




### MJEDISI "SHIKO DHE LEXO"

Për t'i orientuar nxënësit/et për punën që do bëjnë si fotoreporterë, ftohen të vërejnë fotot në libër. Lexohen fjalitë poshtë fotove. Ftohen nxënësit/et të komentojnë me fjalët e veta përmbajtjen e çdo fotoje dhe të ndajnë me shokët e klasës shembuj të ngjashëm me veprimet që paraqiten në foto, të cilët ata i kanë vërejtur gjatë vizitave të tyre në mjediset publike. Parashtrojnë argumentet rreth qëndrimeve që janë dhënë në fotot e tekstit dhe shpjegojnë pse duhet të sillemi në këtë mënyrë në këto mjedise publike. Nxënësit/et në diskutim me mësuesen/in, sjellin shembuj dhe nga mjedise të tjera publike që nuk janë paraqitur në tekst, duke u bazuar në kushtet e mjedisit ku mësojnë, p.sh. në këndin e lojrave, në kopshtin zoologjik etj. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve për punën që do të kryejnë praktikisht në rolin e fotoreporterit.

### MJEDISI "MËSOJ DUKE KËRKUAR"

Pasi nxënësit/et janë pajisur me mjetet përkatëse dhe në varësi të kushteve të klasës, zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda ambjenteve të shkollës. Nxënësit/et, sipas dëshirës së tyre, mund t'i bëjnë pyetje shokëve të klasës, por dhe nxënësve të klasave të tjera të shkollës.

Nëse kjo orë do të zhvillohet nga mësuesja/si, duke shkuar për vizitë në një mjedis publik, nxënësit/et mund të fotografojnë dhe të pyesin dhe persona të tjerë të moshave të ndryshme. Gjatë punës, nxënësit/et mbajnë shënime, bëjnë foto të ndryshme si dhe diskutojnë për rëndësinë që ka zbatimi i rregullave në mjediset publike.

Më pas, nxënësit/et diskutojnë punët e kryera dhe shprehin mendime për çfarë mësuan nga të tjerët. Të ndihmuar dhe nga mësuesi/ja, përmbledhin fjalitë dhe i shkruajnë në libër. Në varësi të kushteve të klasës, nxënësit/et përgatitin postera me punët e kryera dhe i prezantojnë para klasës. Punimet e nxënësve futen dhe në dosjet e tyre personale.

### PËRMBYLLJE

Në fund, bëhet përmbledhja e punës së kryer dhe diskutohet rubrika: Veprim - Pasojë.

Nxënësit/et tregojnë rreth veprimeve që duhet të kryejnë në mjediset publike dhe si mund të kontribuojnë në zbatimin e rregullave në këto mjedise.

Unë zbatoj rregullat në mjediset publike.

↓

Unë përmbush detyrën ndaj vetes dhe të tjerëve.

### VLERËSIMI

*Vlerësim formues:*

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë orës për:
- punët e tyre individuale, në dyshe apo në grup,
- prezantimin e punës së tyre.

Vlerësohen nga mësuesi gjatë orës për:
- llojet e pyetjeve që parashtrojnë

*Vlerësim përmbledhës:*

Vlerësohen nga mësuesi/ja për punët individuale, në punë dyshe apo në grup për:
- fotot,
- produktin e shkruar,
- prezantimet,
- komentet dhe vlerësimin e njëri-tjetrit.

Mësuesi/ja mban evidenca për të bërë vlerësimet përshkruese për të nxënit e nxënësve.

### DETYRË SHTËPIE

Nxënësve u parashtrohen disa detyra shtëpie. Për shembull:
- vazhdimi i punës së fotoreporterit me persona të tjerë.
- paraqitja e punëve me foto dhe me shkrim në poster.

# REFERENCA

Brown, A. L. & Campione, J. C. (1994). *Psychological theory and the design of innovative learning environments.*

Blachowicz, C and Ogle,D (2001). *Reading comprehension: Strategies for Independent Learners, New York: Guilford*

Linn & Burbules (1993). *Construction of Knowledge and group learning*

MAS, (2014). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.*

MAS, (2014). *Kurrikula B***ërthamë** *për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor*.

MAS, ( 2014). *Programi i qytetarisë. Klasa 1 dhe Klasa 6.*

MAS, (2014). *Standardet p***ë***r tekstet shkollore*

*OKB. (1948). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,*

*OKB (1989). Konventa Konventa për të Drejtat e Femijëve.*

Parker.W.C (2005). *Social Studies in Elementary Education. Upper Saddle River, Pearson*

Sunal ,S.C, & Haas,M.E.(2005). *Social Studies for Elementary and Middle Grades: A constructivist Approach. Boston, MA. Pearson*

Thom Markham (2012). *Project based learning.*

Thomas, J. W. 2000. *A review of research on PBL.*

UNICEF, (2006). *Shprehitë pwr jetën.*

https://albania.savethechildren.net/

http://albania.rec.org/

http://www.kksh.org.al/

http://www.unicef.org/albania/